O robi i Allahut, frikësohu se mos ia kthen shpinën fjalës së teuhidit dhe të neglizhosh kuptimin e saj. Dije mirë se kjo fjalë përmban mohimin e tagutit dhe njësimin e Allahut të Madhëruar. Prandaj, mos u bëj mendjemadh në ndjekien e së vërtetës, e ndërkohë bëhesh pasues i tagutit dhe përfundon në humbje të qartë. Allahu i Madhëruar e ka garantuar teuhidin e pastër dhe e ka zgjedhur atë, vetëm për muvehidunët dhe këta janë partia e Allahut. Prandaj, kush vjen me këtë Islam (teuhidin e pastër) pranohet prej tij, e kush vjen me ndonjë fe tjetër do i refuzohet dhe ai bën pjesë tek paria e të humburve.

Thotë Allahu i Madhëruar: **"Ibrahimi i porositi bijtë e tij me këtë fe (fenë e teuhidit), e edhe Jakubi. U thanë: O bijtë e mi, Allahu ua zgjodhi fenë Islame juve, pra mos vdisni ndryshe vetëm se duke qenë muslimanë (të nënshtruar ndaj Allahut)"**.³⁹

Thotë Allahu i Madhëruar: **"Me të vërtetë feja e pranuar tek Allahu është Islami"**.⁴⁰

Thotë Allahu i Madhëruar: **"Kush kërkon fe tjetër përveç Islamit, atij nuk do t'i pranohet dhe në ahiret do të jetë prej të humburve"**.⁴¹

³⁸ Surja Es-Safat, ajeti 33-35.

³⁹ Surja El-Bekare, ajeti 132.

⁴⁰ Surja Ali-Imran, ajeti 19.

⁴¹ Surja Ali-Imran, ajeti 85.

www.Forum-islamik.com

Bëj kujdes, se mos e kufizosh termin e fesë vetëm tek kristianizmi, hebraizmi, ose të ngjashmet me ta, e pastaj të ndjekësh fetë e tjera devijuese dhe të humbësh fenë e vërtetë. Termi fe përmbledh çdo ideologji, metodologji, sistem ose ligj njerëzor që e ndjekin njerëzit dhe janë të kënaqur me të. Gjithë këto që përmendëm bëjnë pjesë tek feja e një populli. Prandaj, bëhet obligim për çdo musliman largimi nga ata, mohimi i tyre dhe i adhuresve që i pasojnë këto fe të pavërteta. Nga ana tjetër e kemi obligim pasimin e partisë së teuhidit dhe fenë Islame.

Allahu i Madhëruar na urdhëron që t'i themi çdo jobesimtari me shumëllojshmërinë e feve të tyre me fjalën e Tij në Kur'an: **“O ju jobesimtarë unë nuk adhuroj atë ç'ka ju adhuroni... deri në fjalën e Tij... ju keni fenë tuaj dhe unë kam fenë time”**⁴² Çdo ideologji nga ideologjitë e mosbesimit që janë bashkuar mbi një sistem dhe metodologji e cila bie ndesh me Islamin, ajo konsiderohet feja e tyre të cilët janë të kënaqur me të.

Fillimisht, tek këto fe bën pjesë paganizmi me të gjitha format e tij, duke filluar nga adhurimi i statujave dhe duke mbaruar tek adhurimi i varreve. Pastaj, në të bëjnë pjesë; masonizmi, liberalizmi, ateizmi, cionizmi, nacionalizmi, fashizmi, komunizmi, socializmi, shekullarizmi dhe në fund globalizmi. Shejtani ua ka inspiruar miqve të tij këto fe, në

⁴² Surja El-kafirun.

www.Forum-islamik.com

mënyrë që t'i humbasin njerëzit nga feja e Allahut të Madhëruar. Pasuesit e këtyre sistemeve të injorancës janë të kënaqur që t'i kenë të gjitha këto ideologji, si fe të tyre. Nga këto fe të shpikura nga shejtani është edhe demokracia, e cila kundërshton Islamin në mënyrë të plotë. Në rrugën e kësaj feje qëndron një shejtan që i thërret njerëzit në zjarr. Prandaj, o robi i Allahut të bëhet obligim që të largohesh nga kjo fe humbëse dhe t'i thërrasësh njerëzit në braktisjen e kësaj feje.

Këtë thirrje ta bësh për arsye:

Përkujtimi për besimtarët...

Tërheqje vërejtje për të shkujdesurit...

Ngritje argumenti për kundërshtarët...

Justifikim para Zotit të botërave në ditën e takimit me Të...

TEMË

DEMOKRACIA, IDHULLI I KOHËS

➤ Njohja dhe kuptimi i çështjeve

Dije o vëllau im, Allahu na udhëzofte tek e vërteta se realiteti i meseleve njihet nëpërmjet tri gjërave:

1. Nëpërmjet realitet fetar.
2. Nëpërmjet realitetit gjuhësor.
3. Nëpërmjet zakonit të një populli.

Thotë ibën Tejmije -Allahu e mëshiroftë-: “Kanë thënë dijetarët e fikhut (jurisprudenca) se emrat janë tri llojesh: Lloji i parë njihet përkufizimi dhe kufiri i tij nëpërmjet sheriatit si p.sh; namazi, zekati etj. Lloji i dytë njihet nëpërmjet gjuhës arabe si p.sh; dielli ose hëna. Kurse realiteti i llojit të tretë njihet përkufizimi i tij nëpërmjet zakonit të popullit. P.sh; shprehja ma’ruf (sjellje e mirë), ashtu siç e përmend Allahu i Madhëruar në Kur’an: **”Kalojeni jetën me gratë tuaja me ma’ruf”**.⁴³

Thotë Taxhu-Din-Subkij -Allahu e mëshiroftë-: “Realiteti i diçkaje ka nevojë që të bazohet diku, ose tek ai që e ka thënë atë. Gjithashtu, ky realitet ka

⁴³ Mexhmuatul-fetaua 13/72 ose 19/235.

www.Forum-islamik.com

nevojë edhe për themeluesin e tij. Nëse ai që e ka themeluar është bazuar tek gjuha, atëherë kemi të bëjmë me një realitet që njihet nëpërmjet gjuhës. P.sh; dihet se luani bën pjesë tek kafshët grabitqare. Nëse Ligjëruesi është Allahu i Madhëruar, atëherë realiteti është fetar, si p.sh; dihet se namazi bën pjesë tek adhurimet specifike që i bëhet vetëm Allahut të Madhëruar.

Kurse kur kemi të bëjmë me një zakon, i përgjithshëm ose i veçantë qoftë ky, atëherë themi se realiteti njihet nëpërmjet këtij zakoni. P.sh; me fjalën kafshë, kuptojmë atë që lëviz me katër këmbë dhe me këtë lloj emërtimi njihet nga gjuha e popullit. Ky lloj emërtimi bën pjesë tek zakoni i përgjithshëm i popullit. Kurse terminologjinë specifike ia vendosin ekspertët e gjuhës dhe gramatikanët për atë lloj familje që bën pjesë kjo kafshë. Kjo ka të bëjë me zakonin e veçantë të këtij populli”.⁴⁴

Thotë Bedru-Din-Zerkushi -Allahu e mëshiroftë:-

“Kur e përdorim një shprehje të veçantë, duhet ta konsiderojmë atë shprehje dhe të punojmë me të, ashtu siç është realiteti i saj. Nuk duhet kuptuar dhe përdorur kuptimi figurativ i saj. Për këtë disa kanë pretenduar ixhmanë, derisa thotë se realiteti ndahet në atë fetar, gjuhësor dhe ai i zakonit”.⁴⁵

⁴⁴ Teshnijful-mesami bi-xhem'il-xheuami të Subkit 1/220.

⁴⁵ Bahrul-Muhijit i Zerkushit 1/514.

www.Forum-islamik.com

Thotë ibën Nexhari -Allahu e mëshiroftë-: “Dije, se me fjalën zakon, nënkuptohet gjuha e popullit. Zakoni është ose specifik ose i përgjithshëm. E vërteta, sipas zakonit të përgjithshëm nuk specifikon një klasë të veçantë. P.sh; nëse kërkojmë origjinën e fjalës kafshë në fjalor, kjo fjalë i referohet çdo gjëje që lëviz, kërcen mbi tokë ose ka thundra. Më pas me kalimin e kohës ky kuptim u harrua dhe nuk u përdor më, me këtë lloj kuptimi. Kurse sot, në gjuhën e popullit tek kafshët bën pjesë kali që kalëron me të njeriu, ose diçka e ngjashme me të”.⁴⁶

Nëse do e kërkojmë kuptimin e demokracisë fillimisht do i referohemi sheriatit, e nëse nuk gjendet në shariat, atëherë fjalorit të gjuhës arabe. Nëse nuk e gjejmë as tek fjalori, atëherë do i referohemi zakonit të popullit. Dihet, se termi demokraci nuk është përmendur as në shariat, as në fjalorin e gjuhës arabe dhe tradita arabe nuk e njeh fare këtë term. Atëherë, ngelet se ajo është përcjellur nga zakoni specifik i një populli, që me kalimin e kohës kjo u bë edhe tradita e tyre. Prandaj, për të njohur realitetin e saj, duhet të kthehemi tek zakoni specifik i atyre që e kanë themeluar për herë të parë demokracinë.

⁴⁶ Sherh-keukebul-munijr të ibën Nexharit. 2\150.

➤ **Përkufizimi i demokracisë sipas themeluesve të saj dhe përkufizimi i saj sipas shariatit**

Kuptuam se demokracia është një term i huaj që nuk është përmendur në shariat dhe gjuhën arabe. Ajo bën pjesë tek zakoni specifik i themeluesve të botës prëndimore dhe me kalimin e kohës u bë edhe tradita e këtij populli. Prandaj, themi:

- Demokracia si term e ka prejardhjen nga gjuha greke, e cila përbëhet nga dy fjalë. Këto fjalë janë “demo” që rrjedh nga fjala greke demos dhe fjala tjetër është kratia. Nëse i bashkojmë këto dy fjalë formohet demokracia, që merr kuptimin se gjykimi ose pushteti i takon popullit.
- Në fjalorin Kulenz, botimi i vitit 1979 thuhet se kuptimi i kësaj fjale është siç vijon; realizimi i gjykimit mes njerëzve duke marrë si ndërmjetës popullin ose përfaqësuesit e tyre.⁴⁷
- Në enciklopedinë politike, përkufizimin e demokracisë do e gjejmë siç vijon; të gjithë

⁴⁷ Libri kuvend konsultimi dhe jo kuvend demokratik, faqe 35-36.

www.Forum-islamik.com

sistemet demokratike janë të themeluara mbi bazën e një ideologjie të vetme. Kjo bazë është e themeluar mbi pushtetin, duke ia dedikuar atë popullit. Sipas kësaj baze populli është përfaqësuesi i sundimit dhe zotërimit. Pra, demokracia në fund të fundit rezulton se origjina e sundimit buron nga populli.⁴⁸

- Kurse në enciklopedinë arabe është siç vijon; Kuptimi i demokracisë do të thotë se populli është i pavarur dhe ai ka të drejtën e sundimit. Demokracia është një sistem politik ku pavarësia i takon gjithë qytetarëve dhe jo vetëm një individ ose shtrese të caktuar.⁴⁹
- Kurse themeluesit e kushtetutës demokracinë e përkufizojnë në këtë mënyrë; demokracia shprehet nëpërmjet kushtetutave, ku përmendet se burimi kryesor i sundimit i takon popullit. Sundimi është një pushtet i lartë që nuk ekziston pushtet tjetër sipër tij.⁵⁰
- Politikani perëndimor Xhozef Frankëll, sundimin e përkufizon në këtë mënyrë;

⁴⁸ Enciklopedia politike. Autori Abdul-Vehab Lejalij 2/756.

⁴⁹ Enciklopedia arabe.

⁵⁰ Sistemet e gjykimit në shtetet e përparuara, faqe 620 botimi 1985

www.Forum-islamik.com

sundimi është pushteti më i lartë, i cili nuk njeh pushtet tjetër më të lartë se ai. Kurse nga ana tjetër zotëron kompetencën e gjykimit të vendimeve që ai merr. Ky kuptim esencial ka qenë i pandryshuar gjatë shekujve të fundit dhe është ruajtur deri në ditët e sotme.

Kuptove, se sipas zakonit specifik të themeluesve të demokracisë, ajo përkufizohet si sundimi i popullit. Kjo është veçoria kryesore e kësaj feje që për hir të saj gumëzhojnë mes njerëzve, bëjnë lëvdata dhe e madhërojnë atë.

Kjo, o njësuës i Allahut në të njëjtën kohë është një nga veçoritë më kryesore të shirkut në ligjënie. Ti e ke kuptuar se baza kryesore që për hir të saj është krijuar njerëzimi, kanë zbritur librat, janë dërguar të Dërguarit, hallka më e fortë e Islamit, është mohimi i tagutit dhe njësimi i Allahut të Madhëruar Një të vetëm pa shok.

Tek adhurimi bën pjesë bindja, gjykimi dhe legjislacioni. Ashtu siç e njëson vetëm Allahun e Madhëruar në dua, ndërmjetësim dhe kurban, gjithashtu ti e ke për detyrë që ta njësosh vetëm Allahun e Madhëruar në bindje, gjykim dhe legjislacion. Nëse robi nuk e njëson vetëm Allahun në të gjitha llojet e adhurimit, ai konsiderohet mushrik. Pasi e mësove këtë mesele, atëherë të bëhet e qartë ty

www.Forum-islamik.com

se demokracia bie ndesh në mënyrë të prerë me Islamin.

Përkufizimi i demokracisë nga ana e sheriatit është siç vijon:

Nga ana fetare feja demokratike përkufizohet si fe e mosbesimit, ku ndjekësit e kësaj feje janë ose “zota ligjvënës”, ose pasues dhe robër të këtyre zotave. Për këtë arsye, demokracia nga njëra anë është kufër ndaj Allahut të Madhëruar, kurse nga ana tjetër është shirk në Zotin e qiejve dhe të tokës në bindje, gjykim dhe legjislacion. Prandaj, këtë fe ia ka shpallur shejtani miqve të tij, në mënyrë që të kundërshtojë fenë Islame që është shpallur nga Rrahmani tek Muhamedi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, që është i Dërguari i Tij.

➤ **Parimet dhe shtyllat kryesore të fesë demokratike**

Feja Islame ka akiden, menhexhin dhe davetin e tij të posaçëm. Kjo fe ka një strukturë komplet të veçantë dhe kjo strukturë është e ndryshme nga të gjitha fetë e tjera. Kjo, sepse Islami është një fe qiellore e zbritur nga Allahu i Madhëruar, kurse fetë e tjera janë ligje njerëzore të inspiruara nga shejtani i mallkuar. Islami thërret në njësimin e Allahut të Madhëruar dhe gjykimin me ligjin e Tij. Ndërsa fetë e tjera thërresin në adhurimin e shejtanit dhe ndjekjen e rrugës së tij. Rruga e vetme për ngritjen e Islamit është pasimi i metodologjisë profetike.

Këtë menhexh i Dërguari i Allahut e ka përmendur në disa hadithe të rëndësishme. Transmetohet nga Muadh bin Xhebeli (Zoti qoftë i kënaqur prej tij) se Profeti sal-Allahu alejhi ue sel-lem i ka thënë atij: **“Themeli i fesë është Islami, shtylla e tij është namazi, ndërsa kupola e tij është xihadi në rrugën e Allahut”.**⁵¹

Kurse shtyllat e Islamit, i Dërguari i Allahut na i ka sqaruar në hadithin e tij që thotë: **“Eshtë ndërtuar Islami mbi pesë shtylla:**

⁵¹ Transmeton Tirmidhiu.

a-) Dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se unë jam i Dërguari i Tij.

b-) Falja e namazit.

c-) Dhënia e zekatit.

d-) Agjërimi i ramazanit.

e-) Haxhi i shtëpisë së shenjtë, kush ka mundësi”.⁵²

Në të njëjtën kohë edhe feja demokratike ka besimin, metodologjinë dhe pikëpamjet e saja. Besimi i kësaj feje bazohet tek pushteti i popullit, kurse metodologjia që përdor demokracia në arritjen e këtij pushteti, janë zgjedhjet parlamentare dhe pluralizmi politik. Ndërsa themeli i thirrjes së saj bazohet tek liria dhe të drejtat e njeriut. Me këtë fe janë sprovuar shumica e thirrësve Islam, e çfarë mund të themi për masën e thjeshtë? Prandaj, po i përmendim me rradhë shtyllat kryesore të kësaj feje, në mënyrë që t'i sqarohet umetit Islam domethënia e saktë e demokracisë. Demokracia është e themeluar mbi shtatë shtylla kryesore. Këto shtylla janë:

1. Demokracia dhe kuvendet parlamentare

Demokracia dhe parlamentet rrjedhin nga feja, zakonet dhe dëshirat e jobesimtarëve. Kënaqja me to

⁵² Transmeton Muslimi.

www.Forum-islamik.com

do të thotë pranimi dhe pasimi i fesë së tyre. Kjo vepër të nxjerr nga Islami. Thotë Allahu i Madhëruar: **“Nëse ju kthejnë në fenë e tyre, atëherë ju nuk do të shpëtoni asnjëherë”**.⁵³ Thotë Allahu i Madhëruar: **“Nëse ti ndjek dëshirat e tyre pasi të ka ardhur e vërteta, atëherë ti je nga të padrejtët”**.⁵⁴

Pra mos u ktheni pas pranimit të Islamit në jobesimtarë duke e ndjekur fenë e tyre. Mos t’iu mashtrojë shejtani duke iu dhënë shpresa për ta vendosur sheriatin nëpërmjet kuvendeve të legjislacionit. Allahu i Madhëruar thotë: **“Shejtani u premtan dhe u jep shpresa njerëzve, por ai nuk u premtan vetëm se mashtrime”**⁵⁵

2. Demokracia dhe kuptimi i saj

Demokracia përkufizohet si pushteti i popullit. Pushteti është sundimi absolut që gjykon çdo gjë dhe ky lloj pushteti nuk gjykohet nga asnjë lloj force tjetër. Këtë pushtet populli e realizon duke zgjedhur përfaqësuesit e tyre, të cilët marrin pjesë nën kupolën e parlamentit. Populli i jep atyre të drejtën e ligjëvënies, nëpërmjet procesit të votimit. Më pas,

⁵³ Surja El-Kehf, ajeti 20.

⁵⁴ Surja El-Bekare, ajeti 145.

⁵⁵ Surja En-Nisa, ajeti 120.

www.Forum-islamik.com

këta përfaqësues, gjykojnë me këto ligje mes njerëzve. Kuvendet e legjislacionit kanë emërtime të ndryshme si kuvendi i popullit, kuvendi i gjykimit, kuvendi i konsultimit etj.

Kjo do të thotë se burimi i legjislacionit dhe i urdhërimit, i takon popullit dhe jo Allahut të Madhëruar. Pra, i adhuruari këtu nga ana e legjislacionit, gjykimit dhe bindjes është njeriu dhe jo Allahu i Madhëruar. Kjo bie ndesh me bazat e Islamit dhe njësimin e Allahut. Thotë Allahu i Madhëruar: **“Askush nuk e shoqëron Atë në gjykimin e Tij”**.⁵⁶

Në një ajet tjetër Allahu i Madhëruar thotë: **“Vetëm Allahut i takon gjykimi, ka urdhëruar që mos të adhuroni tjetër kënd veç Tij”**.⁵⁷

Thotë Allahu i Madhëruar: **“Mos vallë ata kanë zota që u kanë vendosur atyre ligje në fe pa lejen e Allahut”**.⁵⁸

Gjithashtu Allahu i Madhëruar thotë: **“Nëse ju u bindeni atyre, me të vërtetë ju jeni mushrik”**.⁵⁹

⁵⁶ Surja El-Kehf, ajeti 26.

⁵⁷ Surja El-En’am, ajeti 57.

⁵⁸ Surja Esh-Shura, ajeti 21.

⁵⁹ Surja El-En’am, ajeti 121.

www.Forum-islamik.com

Pra, nëse u bindeni atyre përveç Allahut të Madhëruar, ju me të vërtetë i keni adhuruar ata nga ana e bindjes. Nuk përmendet shirku në Kur'an dhe sun-net, vetëm se aty ka një lloj adhurimi që i takon vetëm Allahut të Madhëruar, e ndërkohë ky adhurim i bëhet dikujt tjetri përveç Tij. Allahu i Madhëruar thotë: **“I morën priftërinjtë dhe murgjit për zota përveç Allahut”**⁶⁰ Kështu, i morën si zota përveç Allahut të Madhëruar kur u dhanë atyre të drejtën e legjislacionit, urdhërimit dhe fabrikimit të ligjeve përveç Allahut të Madhëruar.

3. Demokracia dhe shekullarizmi

Demokracia përfaqëson shekullarizmin me plotë kuptimin e fjalës. Ajo e ndan fenë, nga shteti dhe jeta. Sipas saj, Allahu i Madhëruar dhe feja e Tij nuk gjendet vetëm se në xhami dhe vendet e shenjta. Kjo, me kusht që mos të detyrohet askush të futet në këto vende. Kurse për sferat e tjera të jetës si politika, ekonomia, jeta sociale etj, në to nuk ka vend Allahu i Madhëruar dhe ligji i Tij, por populli dhe ligjet e tyre. Gjithashtu, populli ka të drejtë të futet edhe në çështjet e xhamisë nëse kërkohet diçka e tillë.

⁶⁰ Surja Et-Teube, ajeti 31.

www.Forum-islamik.com

Allahu i Madhëruar në lidhje me këtë mendim që kanë jobesimtarët për Allahun dhe fenë e Tij thotë: **“Thanë: “Kjo i takon Allahut sipas pretendimit të tyre dhe kjo është për zotat tanë. Ajo që bëhet për zotat e tyre nuk shkon tek Allahu, kurse ajo ç’ka bëhet për Allahun arrin tek zotat e tyre. Sa keq që gjykuan!”**⁶¹

Thotë Allahu i Madhëruar: **“Ata thonë se besojmë në disa gjëra dhe nuk i pranojmë disa të tjera duke dëshiruar të zgjedhin një rrugë të mesme. Këta janë jobesimtarët e vërtetë dhe Ne kemi përgatitur për jobesimtarët një dënim të dhimbshëm”**.⁶²

Fjala e Allahut **“këta janë jobesimtarët e vërtetë”** është gjykimi i çdo demokraci që e ndan fenë e Allahut të Madhëruar nga shteti, politika dhe çështjet e jetës. Edhe nëse thotë me gojën e tij se unë jam musliman dhe besimtar këtij personi nuk i pranohet Islami i tij, derisa t’i bindet dhe dorëzohet plotësisht ligjit të Allahut të Madhëruar.

4. Demokracia dhe zgjidhja e konflikteve

Demokracia, çdo konflikt dhe mosmarrëveshje që ndodh midis njerëzve e paraqet tek ligjet e njerëzve

⁶¹ Surja El-En’am, ajeti 136.

⁶² Surja En-Nisa, ajeti 150.

www.Forum-islamik.com

dhe jo tek ligji i Allahut të Madhëruar. Kjo gjë bie në kundërshtim me Islamin. Allahu i Madhëruar thotë: **“Nëse keni mosmarrëveshje për diçka, gjykimi i asaj çështjeje i takon vetëm Allahut”**.⁶³

Kurse demokracia thotë se gjykimi i takon popullit dhe jo Allahut të Madhëruar. Allahu i Madhëruar thotë: **“Nëse keni mosmarrëveshje për diçka, paraqiteni atë çështje tek libri i Allahut dhe tek sun-neti i Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, nëse besoni Allahun dhe ditën e fundit”**.⁶⁴

Pra, Allahu i Madhëruar e ka bërë nga obligimet e imanit kthimin e kontradiktave tek libri i Tij dhe sun-neti i të Dërguarit.

5. Demokracia dhe liberalizmi

Demokracia, ia jep të drejtën e lirisë dhe të shprehjes individit pa ndonjë kufi. Individit, sipas demokracisë ka të drejtë të bëjë çfarë të dojë nga kufri, shirku dhe haramet pa dhënë llogari tek askush. Nëse muslimani ndryshon fenë e tij dhe bëhet çifut ose kristian nuk konsiderohet për gjë në ligjet demokratike.

6. Demokracia dhe barazia midis njerëzve

⁶³ Surja Esh-Shura, ajeti 10.

⁶⁴ Surja En-Nisa, ajeti 59.

www.Forum-islamik.com

Demokracia i barazon të gjithë njerëzit në të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, pa shikuar fare në përkatësinë fetare, biografinë individuale dhe moralin që ata kanë. Njeriu më jobesimtar, më i prishuri dhe më injoranti, është i barabartë me më të devotshmin, më të diturin dhe më bamirësin. Edhe nëse bëhet fjalë për çështjet më të rëndësishme, siç janë udhëheqja e njerëzve dhe gjykimi i tyre.

Ky barazim bie në kundërshtim me fjalën e Allahut të Madhëruar që thotë: **“A janë të barabartë muslimanët dhe kriminelët? Si vallë gjykoni në këtë mënyrë?”**⁶⁵

Allahu i Madhëruar thotë: **“A është i barabartë ai që është besimtarë me atë që është i prishur. Ato nuk janë të barabartë!”**⁶⁶

Allahu i Madhëruar thotë: **“A janë të barabartë ata që dinë me ata që nuk dinë?!”**⁶⁷

Në fenë e Allahut të Madhëruar nuk janë të barabartë, kurse në fenë demokratike po.

7. Demokracia dhe mendimi i shumicës

⁶⁵ Surja El-Kalem, ajeti 35.

⁶⁶ Surja Es-Sexhde, ajeti 18.

⁶⁷ Surja Ez-Zumer, ajeti 9.

www.Forum-islamik.com

Demokracia është e themeluar në bazë të konsiderimit, qëndrimit dhe vendimit të shumicës, sido qoftë lloji i shumicës dhe pikëpamjet e tyre në raport me të vërtetën. E vërteta sipas demokracisë është me shumicën, edhe nëse ata bashkohen në të kotë dhe kufër të qartë.

Kurse e vërteta sipas Islamit është ajo ç'ka përputhet me Kur'anin dhe sun-netin, sepse gjykimi i takon vetëm Allahut një të vetëm pa shok dhe jo njerëzve.

Ne, obigo kemi që të kapemi pas kësaj të vërtete me dhëmballë fort, edhe nëse na kundërshton e gjithë bota. Allahu i Madhëruar thotë: **“Nëse ti do të ndjekësh shumicën e njerëzve, ata do të humbin ty nga rruga e Allahut. Ata nuk ndjekin gjë tjetër vetëm se hamendjet”**.⁶⁸

Transmetohet në një hadith të saktë se Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Ka pasur nga Pejgamberët që nuk e kanë besuar dhe ndjekur nga populli i tyre vetëm se një individ”**.

Atëherë si konsiderohet ky Profet bashkë me ndjekësin e tij, në peshoren e shumicës demokratike?

⁶⁸ Surja El-En'am, ajeti 116.

➤ **Këshillë e singertë drejtuar umetit Islam**

Pasi mësove realitetin e fesë demokratike, atëherë të bëhet obligim ty o njësues i Allahut, që ta ndihmosh të vërtetën dhe pasuesit e saj. Duhet që t'i kërkosh pasuesit e së vërtetës dhe të bëhesh pjesë e tyre. Thotë Allahu i Madhëruar: **“Përkufizojë vetën tënde me ata që e lusin Zotin e tyre mëngjes dhe mbrëmje dhe që kanë për qëllim vetëm kënaqësinë e Tij”**.⁶⁹

Këshilla jonë për ty o vëllau im, është:

1. Ti, së pari duhet ta mësosh të vërtetën dhe teuhidin, në mënyrë që t'i njohësh pasuesit e tij, sepse njerëzit njihen nën dritën e së vërtetës.
2. Nëse arrin që t'i njohësh njerëzit të cilët janë më së afërmi thirrjes në teuhid, kapu fort pas tyre dhe ndihmoju atyre sa të kesh mundësi.

⁶⁹ Surja El-Kehf, ajeti 28.

www.Forum-islamik.com

3. Ki kujdes nga miqësia e verbër ndaj personaliteteve, sepse kjo gjë do të bllokojë prej shumë të mirave.

O vëllau im musliman, në këtë kohë janë ngritur shumë flamuj dhe mbartësit e të gjithë këtyre flamujve pretendojnë se janë poshtë flamurit të Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Ne jetojmë në një kohë që të sinqertit i thuhet gënjeshtar, ndërsa gënjeshtarit besnik. Kurse nga ana tjetër është ngritur amaneti nga gjokset e njerëzve.

Prandaj, të këshillojmë që ta marrësh fenë tënde nga të sinqertët dhe nga ata që punojnë për fenë e Allahut sipas metodologjisë profetike. Karakteristikat e njerëzve të së vërtetës, për të cilët duhet që të lidhesh fort pas tyre janë:

1. Ata i përmbahen besimit të Ehlu sun-netit dhe Xhematit.
2. Ata e pasojnë metodologjinë profetike gjatë ngritjes së fesë së Allahut dhe largohen nga shirku dhe bidati.

www.Forum-islamik.com

3. Ata e bëjnë këtë gjë hapurazi, ashtu siç e ka bërë Ibrahim alejhi ue sel-lem, Muhamedi sal-Allahu alejhi ue sel-lem dhe pasuesit e tyre.
4. Ata nuk pasojnë në mënyrë verbale askënd, përveç argumenteve të qarta nga Kur'ani, suneti dhe jeta e selefit.

5. Ata e përmbushin pjesën e tyre, për ta ndihmuar dhe për t'i dhënë fitore fesë së Allahut të Madhëruar.
6. Atyre nuk i bën dëm kundërshtimi i qafirave dhe hipokritave dhe as braktisja e muslimanëve. Ata janë triumfatorë në të vërtetën dhe të ndihmuar nga ana e Allahut të Madhëruar.

Bëhet obligim për çdo musliman pasimi i rrugës së sahabëve gjatë ngritjes së fesë së Allahut në tokë. Ndjekia e tyre është nga bazat e fesë, ku Profeti sal-Allahu alejhi ue sel-lem na porositi duke thënë: **“Keni obligim me pasuar rrugën e sahabëve dhe katër halifëve të drejtë të udhëzuar nga Allahu, të cilët do vijnë pas meje. Kapuni fort me dhemballë pas**

www.Forum-islamik.com

tyre dhe keni kujdes nga shpikjet, sepse çdo shpikje është risi dhe çdo risi të shpie në zjarr.”⁷⁰

Allahu i Madhëruar nëpërmjet tyre e shkatërroi injorancën e parë dhe ata i bëri udhëheqës në tokë duke sjellur drejtësinë, pasi ishte mbushur toka plot padrejtësi. Prandaj, duhet ndjekur rruga e tyre në ngritjen e fesë së Allahut.

➤ **Daveti të bëhet poshtë flamurit të Profetit
sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, o ju
udhëheqës të zgjimit Islam**

Dije, se idhulli i kohës (demokracia) i futi thellë rrënjët e saj në umet kur:

- Umeti Islam u tregua i shkujdesur për fenë e tij.
- Umeti Islam u dobësua nga forca e tij.
- Umeti Islam u tradhëtua nga udhëheqësit e tij.
- Umeti Islam pati injorancë të madhe nga bijtë e tij.

⁷⁰ Transmeton Ebu Daudi dhe Tirmidhiu.

- Feja e demokracisë u neglizhua shumë nga dijetarët e umetit.

Prandaj, ajo ngriti flamurin e saj në vendet Islame dhe hodhi helmin mes tyre. Më pas, përhapi fenë e saj dhe në fund vendosi kuvendet legjislative në çdo vend, për ta ngritur sistemin demokratik në mesin e umetit Islam. Me këtë fitne marramendëse u sprovuan shumica e muslimanëve. Eshtë detyrë e njerëzve të mençur që të meditojnë thellësisht, në lidhje me këto fitne të cilat kanë errësuar sytë e shumicës së muslimanëve. Pastaj, të nxjerrin mësim nga popujt që kanë qenë para nesh. Sidomos në këto ngjarje të mëdha, të cilat kapluan dhe alarmuan të gjithë botën. Nuk ka dyshim, se në të gjithë vendin është përhapur padrejtësia dhe e keqja e kësaj feje.

Kur arriti kjo gjendje, nifaku nxorri ballin e tij, kurse kufri nxorri në shesh dhëmbët dhe armiqësinë e tij. Ishte gati që libri i Allahut të eliminohej, kurse litari i imanit të shpëruhej dhe të shkatërrohej. Jobsimtarët thurën plane që sheriatin e Allahut ta zëvendësojnë me ligjet shejtanike, nëpërmjet pushtimeve të padrejta dhe fjalëve lajkatore. Kurse munafikët dhe ata që kanë sëmundje në zemrat e tyre thanë që Allahu dhe i Dërguari i Tij, nuk na kanë premtuar vetëm se mashtrime. Prandaj, duhet t'i dorëzohemi kufrit dhe ligjeve të tij. Shejtani ua zbukuroi këtë mendim në zemrat e tyre. Për këtë arsye Allahu i Madhëruar ua humbi kuptimin e Islamit, për shkak të nifakut dhe zemrave të sëmura.

www.Forum-islamik.com

Kjo fitne njeriun e mençur e bëri injorant, kurse të sinqertin e dehu dhe ai përfundoi si pijanec në mesin e errësirës së natës. Për shkak të dyshimeve të shumta që mban me vete kjo fitne, të mençurin e bëri si të përgjumur, i cili nuk mund të dallojë dot të keqen nga e mira. Filluan të urrehen zemrat e sinqerta dhe të pastërta, saqë u bënë si zemrat e ujërve që ishin në pritje për të ngrënë delet e vetmuara. Secili xhemat po i bashkangjitet imamit dhe grupit të tij, i cili dallohet qartë në sajë të flamurit që ai mban dhe thërret në të. Kjo fitne po u nxjerr njerëzve në pah fshehtësitë që mbajnë në zemrat e tyre.

Në këtë moment Allahu i dalloj njerëzit e imanit, sigurisë dhe kuptimit, nga njerëzit e nifakut, dyshimit dhe mosbesimit. Gjatë kësaj fitneje Allahu i Madhëruar po i lartëson të sinqertët me gradat më të larta, ashtu siç po i poshtëron munafikët dhe tradhëtarët duke i fundosur ata në humnerat më të ulta. Ndërsa disa të tjerëve ua shlyu dhe ua fali mëkatet. Njerëzit si pasojë e kësaj fitneje, po ndahen mes veti ashtu siç do të ndahen në ditën e llogarisë. Në këtë gjendje që arriti umeti Islam u dallua pala e ndihmuar, e shfaqur në të vërtetën, që nuk i bëjnë dëm atyre kundërshtarët dhe as ata që i braktisin. Si pasojë njerëzit u ndanë në tri parti:

www.Forum-islamik.com

1. Partia që po bën përpjekje për të ndihmuar fenë e Allahut. Këta janë ata të cilët e vërtetojnë teuhidin e Allahut me zemër, gjuhë dhe dorë. Kjo parti po e kundërshton idhullin e kohës demokracinë, secili sipas mundësisë së tij në frontin mediatik, ekonomik dhe atë ushtarak.
2. Partia që po e braktis ndihmën e fesë së Allahut dhe po angazhohet vetëm me të mirat e jetës së kësaj bote. Këta janë ata muslimanë të cilët i japin më shumë përparësi jetës së kësaj bote sesa ndihmës së fesë së Allahut. Gjithashtu tek kjo kategori bëjnë pjesë dhe ata të cilët pretendojnë se kanë dije dhe kuptim, e ndërkohë po braktisin ndihmën e palës së ndihmuar me lloj-lloj arsytimesh të kota.
3. Kurse partia e tretë është pala kundërshtarë e cila po lufton fenë e teuhidit. Tek kjo kategori bëjnë pjesë koalicioni çifuto-kristian bashkë me pushtetarët tradhëtarë dhe munafikët. Këta të fundit iu bashkangjiten këtij koalicioni në luftë kundër Islamit dhe muslimanëve.

Prandaj, le ta shikojë personi veten e tij, a bën pjesë tek pala e ndihmuar, braktisë apo ajo kundërshtarë, sepse nuk ka mbetur parti e katërt. Duke u nisur nga kjo ç'ka përmendëm, ua parashtrijmë disa pyetje atyre që thërrasin në fenë demokratike:

www.Forum-islamik.com

- Si pretendoni thirrjen në teuhid dhe gjykimin me shariat, e ndërkohë ju po e shkatërroni këtë thirrje me duart tuaja duke marrë pjesë në justifikimin dhe forcimin e ligjit të shejtanit?
- Si pretendoni se po i thërrisni njerëzit në adhurimin e Allahut një të vetëm pa shok, e ndërkohë ju jeni të parët që po i respektoni dhe po u bindeni ligjeve të parlamentit?
- Si garoni për ç'rrënjosjen e idhujve, kurse xhemati juaj po bëhet pjesmarrës i sistemit demokratik në rrënjësimin e idhullit më të madh bashkëkohor i cili lejon, ndalon, jep dhe merr, e ky është parlamenti?
- Si pretendoni thirrjen në teuhid që Allahu i Madhëruar na ka urdhëruar që ta mohojmë tagutin dhe në të njëjtën kohë po i nxisni njerëzit që të respektojnë metodat e fesë së tij dhe ata të cilët flasin në emër të tij?
- Kush ia dha parlamentit dhe përfaqësuesve të tij të drejtën e legjislacionit?! Me të vërtetë ju po i mashtroni njerëzit, kur pretendoni se thirrja juaj është teuhidi dhe rruga juaj është metodologjia profetike. Nuk qëndroni vetëm se pak kohë me këtë dave, pastaj filloni t'i thërrisni njerëzit që të marrin tejemum tek muri i parlamentit, duke u ngulitur në këtë formë shenjtërinë e tij në zemrat e tyre.

www.Forum-islamik.com

Pasha Allahun kjo është belaja më e madhe, që kanë rënë në të thirrësit e demokracisë. Por, shumica e muslimanëve nuk e kuptojnë këtë realitet dhe ata mendojnë se kjo çështje ka të bëjë thjesht me largimin e dëmeve dhe arritjen e disa pseudo-dobive.

Prandaj, nuk i lejohet një muslimani që të bëhet pjesë e sistemit demokratik, duke përfaqësuar në kuvendet legjislative dhe të marrë pjesë në zgjedhje. Kjo që përmendëm këtu ka të bëjë me sqarimin e metodologjisë që po ndjekin udhëheqësit e zgjimit Islam në lidhje me thirrjen e tyre në fenë e Allahut dhe jo bërjen qafir të tyre.

O vëllau im musliman! Pjestarët e parlamentit sipas demokracisë, kanë të drejtën e ligjëvënies mes njerëzve. Ata në realitet janë zota rival që adhurohen përveç Allahut të Madhëruar. Ndërsa ata që po i zgjedhin këta pjestarë, në realitet po zgjedhin disa zota ligjëvënës që të gjykojnë mes tyre. Thotë Allahu i Madhëruar: **“Thuaj, o banorët e librit. Afrohuni në një fjalë të vetme që është mes nesh dhe jush. Ajo është që të adhurojmë vetëm Allahun duke mos i bërë shok Atij dhe mos ta marrim njëri tjetrin si zota përveç Allahut. Nëse ata nuk pranojnë, atëherë thuajuni atyre: Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar vetëm Allahut”**⁷¹

Nënshtrimi dhe robërimi ndaj Allahut të Madhëruar, fillimisht bëhet duke pranuar dhe shqiptuar

⁷¹ Surja Ali-Imran, ajeti 64.

www.Forum-islamik.com

shehadetin. Pastaj, kryerjen e të gjitha adhurimeve vetëm për Allahun e Madhëruar dhe në të njëjtën kohë duhet me e ndjekur vetëm ligjin e Tij.

Realiteti i idhullit bashkëkohor nuk ndërlidhet me heqjen e një sundimtari apo të një tjetri. Por, ky realitet ka të bëjë me ç'rrënjosjen e tërësishme të sistemit bashkëkohor të idhujtarisë. Ky sistem është paraqitur në formën e zotave të rinj, të cilët kanë marrë veçorinë e ligjvënies dhe gjykimit mes njerëzve. Daveti duhet të përqëndrohet në ndryshimin e sistemit dhe jo thjesht në heqjen e një sundimtari. Prandaj, vetëm ndjekia e metodologjisë profetike aplikohet për ndryshimin e sistemit të idhujtarisë dhe vendosjen e hilafetit të drejtë. I Dërguari i Allahut nuk e përqëndroi davetin e tij në Meke vetëm duke iu kundërvënë Ebu Xhehlit, por u angazhua në ç'rrënjosjen e idhujtarisë që paraqitej në formën e statujave ku njerëzit u bënë dua këtyre idhujve dhe kërkonin ndërmjetësim prej tyre. Metodologjinë profetike në ndryshimin e sistemit të idhujtarisë bashkëkohore dhe ngritjen e hilafetit të drejtë, po e paraqesim në kapitullin e ardhshëm.

Prandaj, themi me besim të plotë dhe jo me dyshime se gjykimi i demokracisë sipas Islamit është kufër i qartë. Kush e beson atë, thërret në të, e pranon dhe kënaqet me të ose e zbukuron atë pa ndonjë pengesë fetare të konsiderueshme,

www.Forum-islamik.com

ai është jobesimtarë dhe tradhëtarë edhe nëse deklaron me gojën e tij se është prej muslimanëve.

SHKOLLA PROFETIKE

“BEJTUL-MAKDIS”



KAPITULLI

I TRETË

IMANI, URTËSIA DHE NDIHMA E JEMENIT

Transmetohet nga ibën Abasi (Zoti qoftë i kënaqur prej tij) se i Dërguari i Allahut ka thënë: **“O Allah na e begato Shamin dhe Jemenin tone.”** Transmeton Muslimi.

Thotë Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: **“Do dalin nga mesi i Adenit, një ushtri që përbëhet nga 12.000 veta. Këta do e ndihmojnë fenë e Allahut dhe të Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Më i miri prej jush është ai i cili gjendet në mesin e tyre.”** Transmeton imam Ahmedi.

TEMË

NGRITJA E HILAFETIT TË DREJTË SIPAS METODOLOGJISË PROFETIKE

➤ **Meditime rreth menhexhit**

Teksti

Kur flasim për gjendjen e umetit Islam në këtë periudhë të vështirë, duke filluar nga përhapja e shirkut, qoftë ai i adhurimit të varreve apo ai i adhurimit të kushtetutave dhe duke mbaruar me pushtimin e tokave Islame, padrejtësinë, varfërinë, përçarjen etj duhet që të ndjekim metodologjinë profetike në ngritjen e fesë së Allahut në tokë. Thotë Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: **“Ka filluar Islami i huaj dhe do të kthehet i huaj, siç ka qenë në fillimin e tij. Ai do izohet mes dy xhamive**

Mekes dhe Medines, ashtu siç izolohehet gjarpri në vrimën e tij”.⁷²

Shpjegimi

Nëse studiojmë menhexhin e Profetit sal-lallahu alejhi ue sel-lem në fillimet e thirrjes së tij, kuptojmë se i Dërguari i Allahut ia paraqiti fillimisht thirrjen e teuhidit rrethit të tij të ngushtë nga shokët dhe farefisi. Më pas, i Dërguari i Allahut ia paraqiti këtë thirrje fiseve arabe. Ai i thërriste fiset arabe në dy pika kryesore.

Këto pika ishin:

1. Mohimi i Latit dhe Uzës dhe adhurimi i Allahut një të vetëm pa shok.
2. Kërkonte prej tyre ndihmë dhe përkrahje në përhapjen e Islamit.

Thotë ibën Ishaku:-Kam dëgjuar Rebij ibën Ubad (Zoti qoftë i kënaqur prej tij) duke thënë: Isha në Mina me babain tim dhe në atë kohë unë isha djalosh. I Dërguari i Allahut kalonte pranë shtëpive të fiseve arabe dhe u thoshte atyre: **“O bijtë e filanit! Unë jam i Dërguari i Allahut tek ju. Allahu ju urdhëron juve që të pastroheni nga adhurimi i këtyre**

⁷² Transmeton Muslimi.

www.Forum-islamik.com

statujave dhe të adhuroni vetëm Allahun një të vetëm pa shok. Pastaj, të më besoni mua dhe të jeni të sinqertë duke më mbrojtur, derisa t'ua përcjell atë ç'ka Allahu më ka dërguar".

Pas tij ishte një burrë dhe kur u largonte i Dërguari i Allahut ai thoshte: "O bijtë e filanit! Me të vërtetë ky ju thërret juve që të hiqni Latin dhe Uzën nga qafat tuaja! Të braktisni miqtë tuaj prej xhinëve nga Beni Malik bin Ekiysh dhe të ndiqni risitë dhe rrugën e humbjes. Prandaj, mos iu bindni dhe mos dëgjoni prej tij asgjë. I thashë babait tim: O babai im, kush është ky person që e ndjek dhe i kundërpërgjigjet? Tha: Ky është xhaxhai i tij Ebu Lehebi".⁷³

Me të vërtetë në këtë kohë është kthyer Islami i huaj, ashtu siç ka qenë në kohën e të Dërguarit të Allahut. Islami, sot nuk është i huaj nga ana e riteve fetare siç janë namazi, zekati, agjërimi etj, por nga ana e kuptimit të teuhidit dhe mënyrës së ngritjes së shariatit.

Shumica e xhemateve Islame bashkëkohore, duke filluar nga ihuanët dhe duke mbaruar tek shkollat selefije, nuk e kanë kuptuar kuptimin e saktë të fjalës la ilahe il-IAlla. Këto shkolla, janë shumë larg metodologjisë profetike gjatë ngritjes së fesë së Allahut. Ata mendojnë se shirku është thjeshtë adhurimi i varreve, fallxhorëve, magjistarëve, mbajtja e hajmalive etj. Këto gjëra padyshim konsiderohen si

⁷³ Historia e ibën Hishamit, vëllimi i dyte, faqe 48-49.

www.Forum-islamik.com

shirk dhe është obligim për muvehidunët sqarimi i dëmit të tyre tek njerëzit dhe luftimi i tyre. Kurse përsa i përket idhullit të kohës demokracisë, në përgjithësi shkollat e zgjimit Islam nuk flasin fare për rrezikshmërinë e kësaj feje, por në të kundërt janë bërë pjesë e sistemit të saj. Feja e Allahut është e plotë dhe ne jemi të urdhëruar t'ua themi njerëzve atë, ashtu siç ka zbritur pa devijime dhe pa i bërë lajka askujt në thënien e së vërtetës.

Sot, nëse ti do të kërkosh prej kryetarëve të fiseve arabe (pushtetarët arab) që të heqin idhullin e kohës demokracinë nga qafat e tyre dhe të braktisin miqësimin e koalicionit çifuto-kristian, atëherë si do të jetë raporti yt në lidhje me ata? S'ka dyshim se të gjithë këta pushtetarë do të marrin si shembull Ebu Lehebin. Pushtetarët arab bashkë me miqtë e tyre nga koalicioni çifuto-kristian, do t'i drejtojnë të gjitha shigjetat e tyre drejt teje me akuza të ndryshme si terrorist, i humbur, hauarixh, fitnexhi, bidatçi etj.

Pra, në këtë situatë që jemi ne, nuk mundemi që të kërkojmë ndihmë për ngritjen e Islamit nga ky koalicion botëror. Kjo, sepse ky koalicion që në origjinë është themeluar për të luftuar sheriatin e Allahut dhe jo ndihmën e fesë së tij. Meditoni pra, o ju të mençur!

Kurse nga ana tjetër kemi një injorancë dhe neglizhencë të madhe nga ana e umetit Islam, përsa i përket kuptimit të fjalës la ilahe il-lAlla dhe ngritjes së saj në tokën e Allahut. Dije, Allahu na udhëzofte tek

www.Forum-islamik.com

e vërteta, se kjo fjalë nuk është thjesht një shqiptim i çastit dhe më pas të bësh çfarë të duash ti nga shirku dhe mosbesimi. Mirëpo, kjo është një fjalë e rëndë dhe amanet nga ana e Allahut, që të obligon ty mohimin e tagutit dhe njësimin e Allahut Një të vetëm pa shok.

Thotë Abdu Rahman ibën Hasen -Allahu e mëshiroftë-: Fjala la ilahe il-lAlla ka shtatë kushte që nuk i bën dobi kjo fjalë thënësit të saj, vetëm nëse vjen me këto kushte. Këto kushte janë:

1. Dija, e kundërta e saj është injoranca.
2. Siguria, e kundërta e saj është dyshimi.
3. Pranimi, e kundërta e saj është kundërshtimi.
4. Dorëzimi, e kundërta e saj është braktisja.
5. Sinqeriteti, e kundërta e saj është shirku.
6. Vërtetësia, e kundërta e saj është përgënjeshtrimi.
7. Dashuria, e kundërta e saj është urrejtja.

Pastaj thotë: Është kusht për atë që e thotë shehadetin që ta mësojë kuptimin e kësaj fjale, të jetë i sigurtë në atë ç'ka përmban kjo fjalë dhe të punojë me kushtet e saj. Thjesht shqiptimi i shehadetit pa e ditur kuptimin, pa qenë i sigurtë dhe mospunimi me këtë fjalë, nuk i bën dobi robit kjo fjalë. Patjetër duhet të jetë i sinqertë me këtë fjalë dhe të largohet nga

www.Forum-islamik.com

shirku. Tek thënia e shehadetit bëjnë pjesë fjalët e zemrës dhe të gjuhës. Ndërsa tek punët e kësaj fjale, futen punët e zemrës dhe të gjymtyrëve.⁷⁴

Thotë Muhamed ibën Abdul Uehabi -Allahu e mëshiroftë-: Kuptimi i shehadetit Muhamedi është i Dërguari i Allahut, nënkupton bindjen ndaj tij në atë ç'ka urdhëron. Singëritetin ndaj tij në atë ç'ka lajmëron. Largimin nga ajo ç'ka ndalon dhe të adhurohet Allahu sipas mënyrës që ai ka thënë.⁷⁵

Teksti

Këto dy pika që përmendëm, u shfaqën qartë në davetin që i bëri i Dërguari i Allahut fisit Beni Amir bin Sasa'tu. Ky fis e pyeti Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: **"Ku thërret ti, o vëllau i arabëve? Tha: Thërras në dëshminë se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut dhe unë jam i Dërguari i Tij. Pastaj, të më ndihmoni dhe përkrahni mua"**⁷⁶

Shpjegimi

Në këtë hadith shfaqet një kuptim i qartë, se thirrjes dhe kësaj fjale i nevojitet një tokë. Kjo pemë e nderuar duhet të ketë një tokë që të mbijë në të,

⁷⁴ Fethul Mexhijd, faqe 46-49.

⁷⁵ Shpjegimi i tri parimeve të shejh Uthejminit.

⁷⁶ Historia e ibën Hishamit, vëllimi i dytë, faqe 49-50.

www.Forum-islamik.com

sepse ky vend do e ndihmojë këtë fjalë dhe do sakrifikojë për rritjen e saj. Nga këtu, filloi i Dërguari i Allahut që ta kërkontë këtë vend dhe gjatë kësaj kohe bënte dave në Meke. Qëndroi në këtë gjendje trembëdhjetë vite me rradhë, derisa Allahu ia mundësoi tokën e Medines dhe ensarët, të cilët sakrifikuan dhe e përkrahën këtë dave me më të shtrenjtën e tyre. Kur ensarët e morën nën gjirin e tyre daven e teuhidit, vetëm për disa vite u futën njerëzit turma turma në fenë e Allahut.

I Dërguari i Allahut ishte ai që i zbriste shpallja nga shtatë qiejt, më oratori ndër arabët, por megjithatë në Meke e pranuan Islamin vetëm një pakicë prej banorëve të saj. Këtu na bëhet e qartë se kjo fjalë, megjithë peshën dhe vlerën e saj, ka nevojë edhe për disa elemente të tjera që të përfshijë tokën. Këto elemente janë ndihma dhe përkrahja e kësaj feje. Daveti pa përkrahje dhe fuqi ngelet i izoluar. Prandaj, patjetër duhet gjetur një vend dhe ensarë (ndihmues) që ta përkrahin dhe të sakrifikojnë për fenë e Allahut më të shtrenjtën e tyre, në mënyrë që ta përhapin Islamin.

Kjo shfaqet në ditët tona dhe ne kemi shumë nevojë që të gjejmë një vend dhe përkrahës për ta ndihmuar fenë e Allahut. Që kur ka rënë hilafeti i Perandorisë Osmane, në vend të tij në botën Islame janë ngritur shtete arabe të përçara mes veti me kufijtë dhe flamujt e injorancës duke gjykuar dhe luftuar poshtë tyre. Këto shtete në realitet po e luftojnë sheriatin e Allahut duke gjykuar me ligjet e injorancës.

Nga ana tjetër edhe pse ka shumë universitete Islame, shkolla, imamllarë, hatiba, thirrësa, hafiza, xhamia etj prapëseprapë Islami nuk po e përfshin gjithë botën Islame në adhurime dhe ligje, ashtu siç e përfshiu në kohën e Profetit sal-Allah u alejhi ue sel-lem dhe shokëve të tij. Këtu na bëhet e qartë se ne nuk e kemi ndjekur metodologjinë profetike gjatë ngritjes së fesë së Allahut.

Teksti

Menhexhi që shfaqet në ngritjen e fesë së Allahut ndodhet në disa cilësi të caktuara që përmenden në disa ajete të librit të Allahut. Allahu thotë: **“O ju që keni besuar! Kush tradhëton prej jush fenë e tij, Allahu do iu zëvendësojë me një popull, që ata e duan Allahun dhe Allahu i do ata. Janë të dashur me besimtarët dhe të ashpër kundër jobesimtarëve. Luftojnë në rrugën e Allahut dhe nuk i frikësohen kërcënimit të askujt. Kjo është dhuntia e Allahut për këtë popull dhe Allahu jep shume dhe ka dije për çdo gjë”**.⁷⁷

Shpjegimi

⁷⁷ Surja El-Maide, ajeti 45.

Thotë Hamed ibën Atijk -Allahu e mëshiroftë-:
Përsa i përket armiqësimit të jobesimtarëve dhe mushrikëve, dije se Allahu na e ka obliguar këtë dhe e ka përforcuar obligimin e saj. Gjithashtu na e ka ndaluar rreptësisht miqësimin e tyre, derisa nuk do të gjesh në librin e Allahut argumente më të qarta se akidja e uelasë (dashurisë) dhe berasë (urrejtjes) për hir të Allahut, pas obligimit të teuhidit dhe ndalimit nga shirku.⁷⁸

Kur arrin tradhëtia në umet, atëherë cilat janë cilësitë e duhura për t'i kthyer njerëzit në Islam? Allahu i Madhëruar ka përmendur pesë cilësi kryesore. Këto cilësi janë:

1. Dashuria e sinqertë për Allahun e Madhëruar.
2. Dashuria dhe mëshira e madhe për besimtarët.
3. Këshillimi mes veti me butësi dhe urtësi.
4. Ashpërsia dhe forca kundër jobesimtarëve.
5. Xhihadi në rrugë të Allahut me pasurinë dhe veten tonë.

Nëse ne do i zbatojmë këto pesë pika dhe do i edukojmë brezat tanë në bazë të këtyre pikave, me të vërtetë do kemi ndërtuar bazën e fortë që do e ndryshojë gjendjen e umetit. Më pas, kjo bazë do të

⁷⁸ Libri, rruga e shpëtimit dhe liritimit nga miqësimi i tradhëtarëve dhe mushrikëve.

www.Forum-islamik.com

përpiqet dhe do të sakrifikojë për fenë e Allahut, derisa të ngrihet e vërteta dhe të fshihet e kota.

Thotë Profeti sal-IAllahu alejhi ue sel-lem: **“Eshtë ndërtuar Islami mbi pesë shtylla:**

- 1. Dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se unë jam i Dërguari i Allahut.**
- 2. Falja e namazit.**
- 3. Dhënia e zekatit.**
- 4. Agjërimi i ramazanit.**
- 5. Haxhi i shtëpisë së shenjtë, kush ka mundësi”.⁷⁹**

Gjithashtu, kemi edhe hadithin tjetër që i Dërguari i Allahut thotë: **“Ju urdhëroj për pesë gjëra që Allahu më ka urdhëruar mua të punoj më to. Ato janë:**

- 1. Xhemati.**
- 2. Bindja.**
- 3. Dëgjueshmëria.**
- 4. Hixhreti**
- 5. Xhihadi”.⁸⁰**

Vrojtusi shikon se Islami me pesë kushtet e para nuk mund të ngrihet si shtet ose sistem për njerëzimin, pa

⁷⁹ Transmeton Muslimi.

⁸⁰ Transmeton imam Ahmedi dhe Tirmidhiu.

www.Forum-islamik.com

pesë të tjerat. Gjithashtu, nuk ka mundësi që personi të jetë musliman në veten dhe zemrën e tij, e ndërkohë ai gjykon me ligjet e fabrikuara nga dora e njeriut. Ky lloj Islami nuk mund ta përfshijë dot tokën e Allahut.

Kurse Islami që erdhi i Dërguari i Allahut dhe u urdhërua nga Allahu i Madhëruar që ta përcjell atë, është që ta përfshijë të gjithë tokën në adhurime dhe ligje. Njerëzit të gjykohen tek sheriatu i Allahut dhe Islami të mos ngelet thjesht në ritet fetare, siç janë namazi, zekati, agjërimi, haxhi, por patjetër i nevojiten edhe pesë pikat e tjera. Nëse do i bashkojmë që të dy hadithet me njëra tjetrën do na e qartësojnë kuptimin e dave të Profetit.

- Të adhuronin vetëm Allahun Një të vetëm pa shok dhe të mohonin Latin dhe Uzën. Me këtë dave i Dërguari i Allahut nguliti fort teuhidin në zemrat e sahabëve.
- Kërkonte prej fiseve arabe ndihmë dhe përkrahje. Kurse me këtë thirrje synonte themelimin e shtetit Islam, ku ky shtet të bëhej një qendër kryesore për përhapjen e Islamit.

Sakrificat dhe ndihma për fenë e Allahut, duhet të kenë xhemat. Xhemati duhet të ketë bindje dhe

www.Forum-islamik.com

dëgjueshmëri ndaj librit të Allahut, sun-netit të Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe prijësave të muslimanëve. Pastaj, ky xhemat duhet të sakrifikojë për ngritjen e fesë së Allahut në tokë me hixhret dhe xhihad.

Nëse do shohim tekstet Kur'anore dhe profetike, do i gjejmë shumë të qarta këto kuptime. Pra, metodologjia e duhur në ngritjen e fesë së Allahut dhe vendosjen e hilafetit të drejtë bazohet në këto pesë pika:

1. Akidja e pastër dhe menhexhi i qartë, në mënyrë që të bashkohet umeti Islam poshtë flamurit të teuhidit.
2. Grupi i zgjedhur që është themeli, ku sipër tij do të ngrihet shteti Islam. Ky grup është pala që e ndihmon fenë e Allahut. Kjo palë e udhëheq umetin sipas metodologjisë profetike gjatë ngritjes së Islamit.
3. Pjesmarrja e umetit në ndihmën e fesë së Allahut me fjalën, pasurinë dhe jetën e tyre.
4. Bindja, dëgjueshmëria dhe udhëheqja e sinqertë nga ana e prijësave dhe dijetarëve.
5. Mbizotërimi në tokën e Allahut që të jetë fjala e Allahut më e larta.

SHKOLLA PROFETIKE



KAPITULLI I KATËRT

SHKOLLA PROFETIKE E HOROSANIT

Thotë Profeti sal-IAllahu alejhi ue sel-lem: “Do të luftojnë për thesarin tuaj tri vetë. Që të tre janë fëmijët e një udhëheqësi, derisa njëri prej tyre do ta marrë thesarin. Pastaj shfaqen flamujt e zinj nga ana e lindjes. Ata do ju vrasin juve me një vrasje që nuk ju ka vrarë askush tjetër përveç tyre. Më pas i Dërguari i Allahut tha: Kur t’i shihni ata (flamujt e zinj) jepjani besën atyre, edhe sikur t’iu duhet të zvarriteni mbi dëborë për të shkuar tek ata, sepse aty do të jetë Mehdiu. Transmeton ibën Maxhe dhe Hakimiu.

Thotë ibën Kethiri në librin e tij **Fitnet dhe Melhametë**: Mehdiun do ta mbështesin dhe do e ndihmojnë disa muslimanë që do të jenë nga banorët e lindjes. Ata do ia vendosin dhe do ia fuqizojnë bazat dhe pushtetin e tij. Flamujt e tyre kanë për të qenë të zinj. Ai është një zbukurim që tregon seriozitet dhe flamuri i të Dërguarit të Allahut ka qenë i zi. Ai quhej “El-Ukab”.

TEMË

TERBIJA DHE FIKHU I SHKOLLËS PROFETIKE

➤ Terbija dhe fikhu ynë

Metodologjinë Islame në edukimin e umetit, e paraqesim në pesë sfera gjithëpërfshirëse. Këto sfera janë:

- a)** Dija fetare në lëmin e akides (besimit Islam) dhe fikhut (jurisprudenca fetare).
- b)** Edukata e sjelljes, moralit, adhurimeve fetare dhe mirësive.
- c)** Politika fetare ose kuptimi i aktualitetit dhe jetesa me të.
- d)** Përgatitja ushtarake për mobilizimin e umetit ç'ka i nevojitet atij në shkencën e luftës.

e) Praktikimi i xhihadit për largimin e pushtuesit dhe vendosjen e sheriatit.

Nëse keto pesë pika do i shikojmë tek shkollat e zgjimit Islam dhe kontributet e tyre, atëherë si është gjendja e tyre në raport me këto pika?

Këtu ne do të tregojmë gjendjen e përgjithshme të tyre dhe jo anomalitë, sepse çdo shkollë nga shkollat e zgjimit Islam ka mangësitë dhe sukseset e veta lidhur me këto pesë pika.

1. Shkollat përmisuese të sjelljes dhe edukatës

Në këto shkolla bëjnë pjesë xhemati i transmetimit dhe thirrjes (xhemati i tebligut dhe daves), bashkë me shkollat sufiste. Këto shkolla nga aspekti i edukatës, sjelljes, moralit, adhurimeve fetare dhe mirësive kanë punuar shumë. Kurse nga ana e dijes fetare dhe fikhut e kanë të kufizuar vetëm tek prijësit e tyre dhe fare pak tek masa e thjeshtë. Politika fetare dhe kuptimi i aktualitetit gati nuk ekziston fare, vetëm në disa raste të rralla. Përsa i përket përgatitjes dhe praktikimit të xhihadit, kjo nuk përmendet fare mes tyre.

2. Shkollat selefiste shkencore dhe edukative

Në këto shkolla bëjnë pjesë rrymat selefiste “fetare-përmisuese” bashkë me dijetarët dhe nxënësit e dijes

www.Forum-islamik.com

së këtyre shkollave përkatëse. Aspekti i edukatës, sjelljes, moralit, adhurimeve fetare dhe mirësive gjendet shumë pak tek ta. Në përgjithësi tek ata ka mbizotëruar ashpërsia dhe vrazhdësia. Kurse nga ana e dijes fetare, akides, fikhut, rishikimit të gjurmëve të hadithit kanë punuar tej mase. Dijetarët e tyre kanë shumë dije, kurse masa e thjeshtë mjaftueshëm. Nuk kanë ndonjë vizion të qartë, përsa i përket politikës fetare dhe zgjidhjes së problemeve që ka umeti Islam. Kurse në përgatitje ushtarake dhe xhihad nuk njihen fare.

3. Shkollat politike organizative dhe partiake

Në këto shkolla bëjnë pjesë xhemati vëllazëria muslimane (ih'uanu el-muslimun), hizbu tahrijr dhe të ngjashmet me ta nga xhematet politike.

Aspekti i edukatës, sjelljes, moralit, adhurimeve dhe dijes fetare në përgjithësi është i dobët tek ata. Përsa i përket sferës politike, njohjes së aktualitetit dhe kulturës së përgjithshme, puna e tyre në këtë sferë është e bollshme. Kurse në përgatitje dhe xhihad, nuk kanë ndonjë aktivitet, vetëm në disa raste individuale.

4. Shkollat e xhihadit

Këto shkolla i kanë dhënë shumë përparësi përgatitjes ushtarake dhe xhihadit duke i neglizhuar

tri sferat e tjera. Më shumë janë angazhuar me përgatitjen fizike dhe atë ushtarake. Përsa i përket përgatitjes nga ana e edukatës, sjelljes, adhurimeve, dijës dhe politikës fetare kanë punuar mesatarisht ose fare pak.

➤ **Konkluzioni**

Kështu, vërejmë se të gjitha shkollat e zgjimit Islam gjatë punës së tyre, kanë pasur një terbiye të kufizuar në lidhje me dijen fetare, edukatën Islame, politikën fetare, përgatitjen ushtarake dhe praktikimin e xhihadit. Janë përqëndruar më shume tek një ose dy drejtime duke neglizhuar pjesët e tjera. Po t'i paraqesim në një tabelë shkollat e zgjimit Islam dhe metodologjinë e tyre në edukimin e umetit Islam do të kemi:

TABELA E ZGJIMIT ISLAM BASHKËKOHOR

| Shkollat e zgjimit Islam (1930-2003) | Shkollat e xhemateve të tebligut dhe daves | Shkollat e rrymave selefiste të Saudisë | Shkollat politike të ihuanëve | Shkollat e xhihadit |
|---|---|--|--------------------------------------|----------------------------|
| Dija fetare | Dobët | Mirë | Dobët ose mesatarisht | Dobët ose mesatarisht |

| | | | | |
|----------------------|--------------|-----------------------|-----------------------|-----------------------|
| Edukata fetare | Mirë | Mesatarisht ose dobët | Mesatarisht ose dobët | Dobët ose mesatarisht |
| Politika fetare | Shumë dobët | Mesatarisht ose dobët | Mirë | Dobët ose mesatarisht |
| Përgatitja ushtarake | Nuk ekziston | Nuk ekziston | Nuk ekziston | Mirë |
| Lufta | Nuk ekziston | Nuk ekziston | Nuk ekziston | Mesatarisht |

(VITI 1930-2003)

Këtu duam t'i tërheqim vërejtjen shkollës së xhihadit në një pikë të rëndësishme. Kemi vërejtur se një pjesë e mirë e tyre angazhohen vetëm me përgatitjen ushtarake dhe praktikimin e xhihadit. Për këtë marrin si argument hadithin e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ku thotë se xhihadi është kupola e Islamit. Ky është një kuptim i mangët i hadithit, sepse ata kanë marrë vetëm pjesën e fundit të tij dhe e kanë neglizhuar pjesën e parë. Porse hadithi përfshin të gjitha politikat Islame dhe sferat e së mirës. Hadithi i plotë është siç vijon:

Transmetohet nga Muadhi (Zoti qoftë i kënaqur prej tij), se ky e ka pyetur të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: **“O i Dërguari i Allahut. Më lajmëro për një vepër që më fut në xhenet dhe më largon nga zjarri. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i tha: Me të vërtetë ke pyetur për diçka të madhe, por ajo është e lehtë për atë që Allahu ia**

www.Forum-islamik.com

lehtëson. Ta adhurosh Allahun dhe të mos i bësh Atij shok në adhurim. Të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh ramazanin dhe të bësh haxhin nëse ke mundësi. Pastaj tha: A don që të tregoj për dyert e mirësive? Agjërimi është mburojë, kurse sadekaja e fshin të keqen, ashtu siç e fik uji zjarrin.

Pastaj, namazi i natës që fal personi dhe përmendi fjalën e Allahut: “U rrënqethen dhe i lëvizin trupat prej vendi nga frika e Allahut, derisa arriti tek ajeti dhe ata punojnë (sexhde)”. Më tej vazhdoi. A do të tregoj për themelin, shtyllën dhe kupolën e fesë? Thashë: Patjetër, o i Dërguari i Allahut. Tha: Themeli i fesë është Islami. Shtylla e Islamit është namazi, ndërsa kupola e tij është xihadi në rrugë të Allahut. Pastaj më tha: A do të tregoj për gjithë mirësinë e këtyre? Thashë: Po si jo, o i Dërguari i Allahut! E mori gjuhën e tij, e pastaj tha: Ruaje këtë o Muadh. I thash: O i Dërguari i Allahut, edhe për këtë do të japim llogari? Të pastë nëna më tha. A nuk do i fusë njerëzit në zjarr të xhehenemit, vetëm se fjalët që dalin prej gjuhës.”⁸¹

⁸¹ Transmeton Tirmidhiu dhe thotë që është hadith i mirë.

Pra, nëse i kthehemi jetës së sahabëve, tabi'inëve, tabi-tabi'inëve dhe dijetarëve të selefit do të vërejmë se metodologjia e tyre në edukimin e brezave ka qenë e ngritur sipas menhexhit të plotë profetik.

- I Dërguari i Allahut ka qenë shembull i gjallë në të gjitha sferat e jetës. Morali i tij ishte Kur'ani, ashtu siç ka thënë Aishja, Zoti qoftë e kënaqur prej saj. Ai që ka Kur'anin si moral, ka grumbulluar gjithë mirësitë duke filluar nga dija fetare, e duke mbaruar tek moralet më të larta.
- Burimi i gjithë dijes sheriatike tek i Dërguari i Allahut ishte akidja e pastër, e cila të lidhte fort me Allahun e Madhëruar. Me të vërtetë, sun-neti i Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, është një jetë e gjallë praktike për të gjithë brezat që kanë ardhur pas tij, deri në kiamet. E si mos të jetë kështu, e ndërkohë Allahu i Madhëruar e përshekruan në librin e Tij duke thënë: **“Me të vërtetë ti o Muhamed sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, posedon moralet më të larta.”**⁸²
- Metodologjia e tij në sjellje dhe edukatë ka qenë një shkollë e plotë dhe aktuale, që

⁸² Surja El-Kalem, ajeti 5.

www.Forum-islamik.com

sahabët e jetonin atë bashkë me të Dërguarin e Allahut. Nuk ka dyshim se i Dërguari i Allahut me akiden e tij të paluhatshme, fikhun, moralin dhe xhihadin e tij, është shembulli më i lartë dhe më fisnik i të gjitha kohërave.

- I Dërguari i Allahut, fillimisht nguliti akiden e pastër në zemrat e sahabëve dhe me këtë akide u edukua ai brez. Më pas, kjo pemë e bekuar i nguliti fort rrënjët e saj në jetën e sahabëve. Kurse në Medine, u zhvillua gjatë punës me këtë fjalë dhe në fund u pjek në edukatën dhe sjelljen e tyre. Sa i përket adhurimit, devotshmërisë, zuhdit, është i mbushur plot sun-neti dhe jeta e tij.
- Gjithashtu, ka qenë i proekupuar në edukimin e brezit të parë me virtytet më të larta, siç janë vërtetësia, amaneti, bujaria, trimëria, mikpritja, dashuria për njëri-tjetrin, mëshira, respektimi i besimtarëve, sakrifikimi për njëri-tjetrin etj, derisa arritën majat e qiellit.
- Përsa i përket politikës fetare, kuptimit të aktualitetit dhe jetesës me të, ngjarjet janë të shumta në historitë e sahabëve. Qofshin këto ngjarje që kanë ndodhur brenda shoqërisë së tyre ose jashtë Medines, në raport me mushrikët dhe fiset përreth saj.

www.Forum-islamik.com

- Kurse nga ana e përgatitjes ushtarake Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i nxiste shokët e tij për stërvitje, kalorsi, qitje, përgatitje force dhe strategji ushtarake. Ai ishte që prezantonte bashkë me ata betejat, duke i inkurajuar që të garonin për përgatitje financiare dhe fizike kundër armikut.
- Praktika e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në xhihad ka qenë shembulli më i përkryer dhe terbija më e madhe. Ai ka dalë me veten e tij në shumë beteja për të luftuar kundër jobesimtarëve. Përgatiste çetat dhe i dërgonte ushtritë nën udhëheqjen e komandantëve suprem, duke treguar klasin më të lartë në vendet e rrezikut.
- Nuk ka qenë nga sun-neti i Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, vonesa e personit për xhihad pasi ai pranonte Islamin, deri në një periudhë të caktuar kohore në mënyrë që ai të edukohej në Medine dhe pastaj të ishte i gatshëm për luftë. Sun-neti i tij është që dija dhe puna ecin paralelisht dhe ata janë të pandara nga njëra tjetra. Ky kuptim, shfaqet qartë kur sahabiu i nderuar i kërkoi leje Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, që të luftonte kundër mushrikëve, por ai në atë gjendje ishte jomusliman. Kurse

www.Forum-islamik.com

Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, e këshilloi duke i thënë: **“Prano Islamin, pastaj lufto.”**

Nga këto që përmendëm nxjerrim në konkluzion se metodologjia e tij në edukimin e sahabëve ishte e plotë. Kjo metodologji përfshin të gjithë sferat e jetës dhe bazohet në këto pesë pika:

- a) Dija fetare në lëmin e akides (besimit Islam) dhe fikhut (jurisprudenca fetare).
- b) Edukata e sjelljes, moralit, adhurimeve fetare dhe mirësive.
- c) Politika fetare ose kuptimi i aktualitetit dhe jetesa me të.
- d) Përgatitja ushtarake për mobilizimin e umetit ç’ka i nevojitet atij në shkencën e luftës.
- e) Praktikimi i xhihadit për largimin e pushtuesit dhe vendosjen e sheriatit.

Selefët tanë kanë kontribuar shumë në edukimin dhe udhëzimin e umetit me këto pesë pika, duke lënë pas veti gjurmë praktike. Historitë, ngjarjet dhe përvojat e tyre janë të shumta dhe këto gjenden në jetën e tyre. Duke u bazuar në atë ç’ka përmendëm dhe përvojën tonë gjatë zgjimit Islam, themi se kjo është e vetmja metodologji e bazuar në librin e Allahut, sunetin e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe kuptimin e selefëve për edukimin e umetit. Prandaj, e shohim si një këshillë dhe obligim për dijetarët,

www.Forum-islamik.com

thirrësit Islam bashkë me shkrimtarët e tyre, që të bëjnë përpjekjen maksimale në edukimin e brezit të ardhshëm në bazë të këtyre pesë pikave. Me këtë lloj terbiye ata do të ringjallin trashëgiminë profetike bashkë me atë të sahabëve në mesin e muslimanëve.

SHKOLLA PROFETIKE

“HOROSAN”



KAPITULLI

I PESTË

LUFTIMI I ROMAKËVE DHE RAFIDIVE NE TOKËN E IRAKUT

Transmetohet nga ibën Abasi (Allahu qoftë i kenaqur prej tij) se i Dërguari i Allahut ka thënë: **“Në kohën e fundit do të dalë një popull që quhen rafidi, të cilët do të refuzojnë Islamin. Kur ta shikoni atë popull vritini ata, sepse ata janë mushrik”**. Transmeton Ebu Jala dhe Tabareniu.

Transmeton Muslimi se një burrë i kërkoi Profetit sal-Allahu alejhi ue sel-lem që ta bekonte Irakun. Profeti sal-Allahu alejhi ue sel-lem i tha: **-Në të gjendet briri i shejtanit. Nxitja e fitneve dhe e keqja, do të jetë nga ana e lindjes”**. Transmeton Muslimi.

www.Forum-islamik.com

Historia ka treguar se huarixhët, shijat, batinitë, kaderitë, xhehmitë, ideologjitë zjarrputiste, mongolët dhe në kohën tonë shijat e Iranit dhe Irakut bashkë me romakët e kohës nga amerikanët dhe evropianët, janë ndezur dhe kanë dalë nga lindja.

TEMË

QARTËSIMI I DYSHIMEVE NË TOKËN E IRAKUT

- **Lufta në Irak është xhihad, në baza të sheriatit dhe polemika kundër tij është në kundërshtim me sheriatin**

Falenderimet dhe bekimet janë vetëm për Allahun, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Muhamedin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe mbi gjithë ata që ndjekin rrugën e tij deri në ditën e gjykimit.

Fillimisht vëllezër përkujtojmë veten tonë dhe të gjithë juve me fjalën e Allahut të Lartësuar ku thotë:

"O ju që besuat, bindjuni All-llahut, bindjuni të Dërguarit dhe të parëve nga mesi i juaj. Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtrojeni atë te All-llahu (libri i Tij) dhe te i Dërguari (sun-neti i tij), nëse i besoni All-llahut dhe ditës së fundit. Kjo është më e dobishme dhe përfundimi më i mirë".⁸³

Po ashtu Allahu i Lartësuar thotë: **"Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë derisa të të zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt mes tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndiejnë pakënaqësi dhe derisa t'i dorëzohen plotësisht gjykimit tënd".⁸⁴**

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem thotë: **"Kush pajtohet me ne ka hyrë ne xhenet, e kush na kundërshton ka refuzuar".⁸⁵**

Thotë Imam Shafiu -Allahu e mëshiroftë-: "Janë gjithë muslimanët të një mendimi dhe ka ixhma, se atij që i bëhet i qartë gjykimi i Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, nuk i takon më një muslimani që ta braktis atë gjykim për shkak të ndonjë thënie të ndonjë dijetari".

⁸³ Surja En-Nisa, ajeti 59.

⁸⁴ Surja En-Nisa, ajeti 65.

⁸⁵ Transmeton Buhariu.

Ka thënë Imam Ahmedi -Allahu e mëshiroftë:-
"Mos më pasoni mua dhe mos i pasoni të afërmit nga mesi juaj, apo ata që kanë pozitë, por merrni nga marrin ata". Pra, merrni nga Kur'ani dhe sun-neti.

Çështjen të cilën ne e kemi për qëllim ta sqarojmë, flitet se për këtë mesele ekziston mosmarrëveshje mes dijetarëve. Ne do t'i cekim fetvatë e këtyre dijetarëve të cilët e kundërshtojnë këtë mesele, më pas do të përmendim argumentet e qarta nga Kur'ani, sun-neti dhe ixhmaja e umetit për këte çështje.

Kjo çështje ka të bëjë me luftimin e pushtuesve dhe tradhëtarëve, që në rastin tonë është Amerika dhe Qeveria Shi'ite e Irakut. Luftimin e pushtuesve dhe pushtetarëve të cilët janë në koalicion me amerikanët në luftë kundër terrorizmit, disa dijetarë e konsiderojnë haram, duke u argumentuar se është fitne e madhe.

Thonë se ata që luftojnë nuk kanë flamur të qartë, janë fitnexhi, huarixha, vrasin muslimanët etj. Këtë gjë e thonë dijetarët e Saudisë, ku më të spikaturit prej tyre janë:

Shejh Feuzani thotë se një ndër pengesat që kanë muslimanët të luftojnë në Irak, është sa ata nuk kanë flamur të qartë dhe lufta kundër Amerikës është fitne.

www.Forum-islamik.com

Shejh Ubejkani thotë se rezistenca në Irak po lufton kundër qeverisë legjitime të Irakut. Prandaj, obligohet për muslimanët ta respektojnë këtë qeveri dhe është e ndaluar dalja në luftë kundër tyre.

Këto argumente thonë se i kanë nxjerrë nga fjalët e Ibën Muflih El-Hambelij (nxënës i Ibën Tejmijës), e disa dijetarëve të tjerë të Islamit.

Fetvatë të cilat i cekëm nga shejh Ubejkani dhe shejh Feuzani janë batil (të pa vlefshme). Këto fetva nuk kanë argument nga Kur'ani, sun-neti dhe as nga ixhmaja e umetit. Dihet se kontradiktat mes muslimanëve dhe mosmarrëveshjet që kanë mes veti zgjidhen nëpërmjet argumenteve dhe fakteve të qarta nga sheriatit. Për këtë arsye nuk kanë vend në të fjalët, nëse këto mendime nuk janë të bazuara në argumentet e qarta shariatike.

Ajo që duam të theksojmë dhe të japim fetva në këtë temë, është se xhahadi ndaj amerikanëve dhe qeverisë prezente që është vendosur nga ana e tyre është farz ajn (individual) për banorët e Irakut musliman. Pastaj, për ata që janë më afër tyre. Obligohen që të gjithë muslimanët kudo që gjenden ata, që t'i ndihmojnë popullit musliman të Irakut në çdo front.

- **Argumentet nga Kura'ni për luftimin e jobsimtarëve**

Një: Nga Kur'ani ka argumente të dobishme dhe të shumta, por mjafton nga ato t'i cekim vetëm tri prej tyre. Allahu i Lartësuar thotë: "**Ata që po sulmohen me luftë, u është dhënë leje të luftojnë...**".⁸⁶

S'ka dyshim se muslimanëve të Irakut iu bëhet zullum, dhunë, padrejtësi dhe ajeti është i qartë për lejimin e luftës kundër armikut.

Dy: Allahu i Lartësuar thotë: "**Luftoni të gjithë idhujtarët pa dallim, siç ju luftojnë ata juve pa dallim**".⁸⁷

Ky ajet nuk është i anuluar me ixhmanë e dijetarëve, edhe nëse bëhet fjalë për xhihadin sulmues. Pra, ne e kemi obligim që t'i luftojmë idhujtarët, edhe nëse ata nuk na luftojnë neve. Kjo bëhet për të luftuar shirkun dhe për të përhapur teuhidin dhe drejtësinë në tokën e Allahut. Dihet se lufta në Irak është mbrojtëse dhe kjo gjë e bën edhe më obligative luftimin e pushtuesit. Për shkak se pabesimtarët i kanë bashkuar ushtritë dhe fuqitë e tyre për t'i luftuar muslimanët, atëherë bëhet obligim për të gjithë muslimanët luftimi i tyre, ashtu siç ata na luftojnë neve. Fjala e Allahut të Madhëruar: "**Luftoni pabesimtarët**", është në formë

⁸⁶ Surja El-Haxh, ajeti 39.

⁸⁷ Surja Et-Teubeh, ajeti 36.

www.Forum-islamik.com

urdhërore. Prandaj, urdhëri i Allahut është obligim për muslimanët.

Tre: Gjithashtu Allahu i Lartësuar thotë: **"O ju që besuat! Luftoni jobesimtarët që i keni më afër jush, e le ta ndejnë prej jush grushtin e fortë kundër tyre".**⁸⁸

Ky ajet është i qartë pa kurrfarë dyshimi se lufta kundër jobesimtarëve, që janë më afër nesh është obligim fetar. Kurse në Irak, Afganistan, Pakistan, Jemen, Somali, Algjeri, Çeçeni, Palestinë etj është edhe më parësore, sepse në këto vende zhvillohet xhihad mbrojtës dhe ky është qëllimi dhe konkluzioni i ajetit. Amerika me koalicionin e saj po zhvillon një luftë kundër umetit Islam dhe dihet se ata janë idhujtarë (Ehlul-kitabi). Gjithashtu, muslimanët në Irak dhe Afganistan po shtypen dhe po bëhet zullum kundër tyre. Për këtë arsye nuk ekziston siguri, paqe, drejtësi dhe marrëveshje me amerikanët. Pushtimi i tyre është i qartë dhe dhuna është e dukshme. Atëherë është normale luftimi i tyre për shkak të fjalës së Allahut: **"Luftoni jobesimtarët që i keni më afër jush...** dhe ky ajet është në formë urdhërore.

⁸⁸ Surja Et-Teubeh, ajeti 123.

- **Argumentet nga sun-neti për luftimin e jobsimtarëve**

Argumentet nga sun-neti janë të qarta dhe të shumta, por ne do të mjaftohemi vetëm me tre prej tyre:

Një: Transmeton Ebu Hurejre (Allahu qoftë i kenaqur prej tij) se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: **"Jam i urdhëruar që t'i luftoj njerëzit, derisa të dëshmojnë se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut".**⁸⁹

Ndërsa Amerika bashkë me qeverinë prezente çfarë janë duke vepruar? Normal se po mundohen me i larguar njerëzit nga fjala la ilahe il-lAllah, apo me ia ç'rrënjosur besimin muslimanëve nëpërmjet përhapjes së fesë demokratike. A nuk është këtu më parësore dhe më obligative lufta kundër tyre? Tregoni pra sinqerisht, o ju dijetar të nderuar! Ajo që po ndodh në Irak dhe Afganistan është pushtimi i tokave Islame nga ana e krishterëve dhe ky është qëllimi i tyre. Këtë luftë që po e zhvillojnë kundër Islamit po e kuptojnë të gjithë, përveç injorantit dhe atij që nuk sheh.

⁸⁹ Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

www.Forum-islamik.com

Nëse thoni se zanafilla e luftës kundër pabesimtarëve nuk bëhet që ata ta pranojnë Islamin, por lejohet vetëm në atë rast kur ata na luftojnë neve, atëherë si ta kuptojmë hadithin e mësipërm që flet qartë për luftimin e jobesimtarëve derisa ata të futen në Islam ose të japin xhizjen duke qenë të nënshtruar ndaj ligjit të Allahut? Po si i bëhet çështja kur jobesimtarët dëshirojnë ta ç'rrenjosin fenë e Allahut, shtypjen dhe okupimin e muslimanëve, marrjen e nderit të grave muslimane nëpër këmbë dhe vjedhjen e pasurisë së tyre? Nuk ka dyshim se lufta në këtë rast bëhet farz ajn, për çdo person i cili ka mundësi.

Dy: Fjala e Pejgamberit sal-Allahu alejhi ue sel-lem ku thotë: "**Kush vritet duke e mbrojtur veten, ai është shehid dhe kush vritet duke e mbrojtur pasurinë, ai është shehid.**"⁹⁰

Erdhi Amerika në tokën Islame dhe ajo po e grabit pasurinë dhe po e ç'nderon nderin e muslimanëve. S'ka dyshim se lufta kundër tyre është legjitime pa ndonjë kurrfarë polemike, edhe nëse bëhet thjesht për mbrojtjen e vetes dhe nderit. Kurse fjalët e shejh Feuzanit dhe Ubejkanit, që e kundërshtojnë rezistencën në Irak me pretendimin se nuk kanë

⁹⁰ Transmeton Tirmidhiu, Nesaiu dhe Ebu Davudi.

www.Forum-islamik.com

flamur të qartë, është e kotë në bazë të hadithit që na e obligon mbrojtjen e vetes dhe të nderit.

Shejh Feuzani në një fetva tjetër e lejon rezistencën në Irak, vetëm nëse qëllimi i Amerikës është për t'i luftuar muslimanët. Nuk ka dyshim se qëllimi i Amerikës në tokën Islame është për t'iu sjellë mosbesim, dhunë dhe padrejtësi muslimanëve. Kjo është ajo ç'ka duket në sytë tanë, ndërsa mund të duket ndryshe vetëm për ata, që në esencë nuk e shohin këtë realitet.

Tre: Fjala e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: **“Prej jetës më të mirë njerëzore, është jeta e një personi i cili është i kapur për litarin e kalit të tij në rrugën e Allahut, dhe sa herë që dëgjon ndonjë thirrje apo britmë, ai vrapon pas saj, duke kërkuar luftën dhe vdekjen”.**⁹¹

- **Ixhmaja e dijetarëve Islam**

Ixhmaja e muslimanëve për obligimin e luftës në Irak dhe Afganistan është e njohur dhe e prerë nga Kur'ani, sun-neti dhe selefi. Janë pajtuar të gjithë selefët në obligueshmërinë e luftës ndaj armikut, i cili sulmon vendet muslimane. Gjithashtu, ata e kanë lejuar luftën edhe kundër muslimanëve nëse këta të

⁹¹ Transmeton Muslimi.

www.Forum-islamik.com

fundit plaçkisin pasurinë dhe luftojnë kundër të parit të muslimanëve dhe xhematit musliman, siç janë hauarixhët. Atëherë, çfarë mund të themi kur ai që sulmon është nga jobesimtarët? Nuk ka dyshim që në këtë rast lufta është edhe më obligative.

Për këtë kanë dhënë fetva shumë dijetarë të njohur, si p.sh; hanefitë, malikitë, shafitë, hanbelitë, imam Neueviu, ibën Rexhebi, ibën Tejmije dhe shumë të tjerë nga dijetarët e Islamit. Të gjithë këta kanë treguar se xhiahadi mbrojtës, nuk ka pasur asnjëherë kundërshtime mes dijetarëve të umetit Islam. Atëherë pse duhet të ketë polemikë për armikun që gjendet në Irak, kur dihet se ai okupon, shtyp, plaçkit dhe ç'nderon krenarinë e muslimanëve dhe gjërat e shenjta të tyre? Mbrojtja e shenjtorëve të Islamit është obligim dhe për këtë nuk ka polemikë në sheriatin e Allahut.

Ndërsa fetvatë e cekura nga shejh Ubejkani dhe shejh Feuzani, janë në kundërshtim me sheriatin dhe me ixhmanë e umetit, prandaj këto fetva janë të pavlefshme. Për këtë arsye, e shohim si obligative sqarimin e këtyre fetvave në mënyrë të detajuar për t'iu kundërpërgjigjur dyshimeve të tyre me argumentet e qarta shariatike. Pozicioni i dijetarëve është i njohur në fenë Islame, por asnjëri prej tyre

www.Forum-islamik.com

nuk është i pagabuar, përveç Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

➤ **Kundërpërgjigje ndaj fetvasë së shejh Feuzanit në mënyrë të detajuar**

Shejh Feuzani argumentohet me fjalën e Ibën Muflih El-Hanbelij dhe thotë se lufta në Irak është fitne. Prandaj, nuk lejohet të luftohet sepse nuk ka flamur të qartë.

Shejh i nderuar, themi se lufta në Irak lejohet për muslimanin në mënyrë që ai të mbrojë veten dhe nderin e tij prej armikut. Flamuri në luftën mbrojtëse nuk është prej kushteve të xihadit, prandaj muslimani duhet që ta mbrojë veten, pasurinë dhe nderin e familjes së tij me çdo gjë që ai posedon. Për këtë arsye, kjo fetva është e pavlefshme nga Kur'ani, sun-eti dhe Ixhmaja e umetit. Shkaqet janë të shumta, e ndër to përmendim:

www.Forum-islamik.com

1. Xhiahadi në Irak, është xhihad për mbrojtjen e fesë, vetes, tokës, pasurisë dhe vendit të muslimanëve. Këto që përmendëm janë shumë të shenjta në përgjithësi për të gjithë njerëzit, e ç'ka mund të themi për muslimanët në veçanti?! Si ka mundësi që në këtë gjendje, lufta të jetë fitne? Ndërsa e kundërta, e cila është lënia e luftës në këtë gjendje është fitne. Për arsye se me lënien e luftës përhapet shirku, zullumi, mbizotërojnë rafiditë, laikët, komunistët dhe jobesimtarët në pushtet. A ka fitne më të madhe se fitneja e këtyre, o shejh i nderuar? Thotë Allahu i Lartësuar: "**Dhe luftoni ata derisa të mos mbetet fitne (idhujtari, besim i kotë, politeizëm)**".⁹²

2. Qëndrimi i Amerikës dhe Qeverisë Shi'ite në Irak, është një qëndrim me qëllim okupimi dhe për këtë nuk ka polemikë se nuk është kështu. Nëse amerikanët dhe shijat konsiderohen si pushtues, atëherë obligohet për dijetarët që të japin fetva për një status të tillë. Këtu kemi të bëjmë me një pushtim që në rastin tonë është pushtimi i Irakut nga ana e amerikanëve dhe ndihmësve të tyre. Prandaj, xhiahadi në këtë rast jo vetëm që nuk është i ndaluar, por

⁹² Surja El-Enfal, ajeti 39.

lejohet dhe obligohet për çdo musliman që ka mundësi.

3. Xhihadi mbrojtës nuk kushtëzohet me flamur as me halife, sepse kjo luftë bëhet për t'u mbrojtur nga armiku i cili sulmon në çdo lloj mënyre. Kurdo që të bëhet sulmi, mbrojtja ndaj armikut në këtë rast, është obligim dhe nuk e ka kushtëzuar flamurin askush nga dijetarët e umetit për xhihadin mbrojtës. Nuk ka njeri që ka thënë kështu. Kush pretendon që ka ndonjë transmetim le të na e sjellë. Argumentet që sjellin dijetarët për këtë çështje duhet të kenë baza nga Kur'ani dhe sun-neti, përndryshe ata janë të refuzuara sipas fjalës së Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: **"Kush thotë diçka në fenë tonë, që nuk është prej saj, ajo është e refuzuar"**⁹³

4. Për flamurin të cilin flet shejh Feuzani s'ka dyshim se është prezent. Flamuri i muxhahidëve është i qartë dhe për ata që nuk kanë njohuri, u themi se është flamuri me ngjyrë të zezë, ku në mes ka gurin e bardhë me vulën profetike që shkruhet fjala la ilahe il-lAlla, Muhamedur- resulull-llah. Ky është flamuri i Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem që është ngritur në tokën e Irakut. Atëherë, pse nuk na e tregoni ju, flamurin e prijësave tuaj? Shteti Islam i Irakut që po

⁹³ Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

lufton kundër Qeverisë Shi'ite, e cila është vendosur nga ana e amerikanëve, kanë njohuri të qarta rreth objektivave ushtarake. Menhexhi i tyre në ngritjen e fesë së Allahut është i qartë, siç shihet dielli në mesin e ditës.

Ky menhexh është daveti dhe xihadi poshtë flamurit të Profetit sal-lAllahu alejhu ue sel-lem. Gjithashtu, ata kanë një politikë me baza të qarta Islame ku synojnë vendosjen e hilafetit të drejtë sipas metodologjisë profetike dhe ç'lirimin e Palestinës. Ndërkohë që xihadi është legjitim që në esencë, flamuri dhe emiri janë prezent, atëherë për çfarë arsye duhet të vonohet çështja e xihadit në këtë vend?

5. Kushtëzimin e flamurit disa e kuptojnë se duhet të jetë prezent shteti dhe udhëheqësi, prandaj i vendosin si kushte xihadit mbrojtës, halifen dhe shtetin. Sipas tyre jobesimtarët le të futen në shtëpitë e muslimanëve, të dhunojnë, ç'nderojnë, torturojnë dhe të përhapin mosbesimin, kurse muslimanëve u ndalohet lufta, përderisa nuk ka shtet Islam dhe halife. Këtë nuk e pranon as llogjika e shëndoshë, e si mund të themi se ka argumente fetare!

6. Dijetarët muslimanë gjatë kohërave dhe shekujve nuk e kanë sjellë këtë kusht të pavlefshëm dhe nga

www.Forum-islamik.com

ata dijetarë është edhe vetë shejh Feuzani. Mos të harrojmë se më herët për luftën në Afganistan dhe Palestinë shejhu i nderuar ka qenë prej atyre që e kanë mbështetur xihadin në Afganistan dhe Palestinë kundër pushtuesit rus dhe atij çifut. Këto fetva janë me shkrimin e tyre. Në atë kohë xihadi në Afganistan dhe Palestinë jo vetëm që nuk ka pasur flamur, por ka qenë i përzier me ndjenja atdhetare dhe komuniste. Atëherë, si shejhu e ka bërë të lejuar xihadin afgan në atë gjendje që kanë qenë, kurse në Irak e ndalon me preteksin se nuk kanë flamur dhe është fitne? Ku është ndryshimi midis Rusisë dhe Amerikës? Që të dy janë pushtues dhe armiq të Islamit, me një ndryshim të vetëm se Amerika e ka tejkalu në vrasje, shkatërrim, burgosje, mosbesim dhe mashtrim.

7. Këshilli i lartë i dijetarëve në Saudi ku shejh Feuzani është njëri prej tyre kanë dhënë fetva të qarta për luftimin e Sadam Husejnit. Luftimin e tij e kanë konsideruar xihadin më të lartë, në mënyrë që të mbrohej Kuvajti në atë kohë nga ai tagut. Ushtria e Saudisë e luftoi Sadamin poshtë flamurit të Saudisë me fetvanë e komisionit të përhershëm të dijetarëve. Ata e konsideruan luftimin e Sadamit në atë kohë, xihadin më të lartë. Ndërsa sot, e konsiderojnë luftimin e Amerikës në tokën e Irakut për të mbrojtur

www.Forum-islamik.com

këtë tokë, fitnen më të madhe. Subhanalla! O shejh i nderuar, po Qeveria Shi'ite e vendosur nga amerikanët çfarë konsiderohet në syrin e muslimanëve? Ose pranoni se Amerika bashkë me qeverinë e saj në Irak është tagut, ose thoni se shteti Islam në Irak është i padrejtë në luftimin e tagutit? Presim përgjigje nga shejhu i nderuar me të njëjtën zgjidhje siç iu dha Sadamit në atë kohë.

8. Shejhul Islam Muhamed Ibën Abdul Vehab, në shumë shkrimet e tij tregon qartë se lufta që ka pasur me kundërshtarët e tij nga shteti Osman dhe prijësit e asaj kohe, ka qenë për të mbrojtur fenë, nderin dhe pasurinë. Ka qenë e njohur se thirrja Muhamed ibën Abdul Vehabit ka qenë kundër udhëheqësve osmanllinj, e megjithatë lufta e shejhut kundër tyre ishte legjitime. Gjenden shumë shkrime nga dijetarë të shumtë që e kanë lejuar luftën kundër turqve të cilët dëshironin vrasjen e muvehidunëve dhe kontrollin e kufirit të Nexhdit. Atëherë, pse cilësohet fitne lufta kundër Amerikës në Irak, kur dihet se populli i Irakut po lufton për të mbrojtur fenë, nderin dhe pasurinë?! A nuk e ka shpallur qartë Amerika kryqëzatën e saj moderne kundër botës Islame?

9. Fjalët e shejh Feuzanit janë të qarta se lufta në Irak është fitne, që do të thotë se xihadi kundër amerikanëve është i ndaluar. Nëse e bëjmë një

www.Forum-islamik.com

krahasim mes qeverisë prezente, bashkë me Amerikën në njërën anë dhe muxhahidëve për kthimin e sheriatit në anën tjetër, do të kemi; kuptohet se pikësynimi i muxhahidëve është ngritja e fjalës së Allahut dhe flamuri i tyre është i qartë për atë që posedon sy. Atëherë pse nuk e llogarisni dhe nuk e vlerësoni flamurin e muxhahidëve si flamur legjitim? Ndërsa flamurin e Qeverisë Shi'ite e cila është vendosur nga amerikanët për të luftuar Islamin dhe muslimanët, llogaritet si flamur legjitim? Dihet se muxhahidët nuk po luftojnë për pasuri dhe pozitë, por për largimin e armikut okupator nga vendi Islam dhe kjo mesele është e qartë në sheriatin Islam. Atëherë lind pyetja, se çfarë ka për qëllim Qeveria Shi'ite me mikun e saj Amerikën në Irak? Besoj se pyetja nuk ka nevojë për përgjigje.

10. Këtë fetva shejh Feuzani e kundërshton me një fetva tjetër ku ai e ka lejuar luftën për ata që sulmohen, sepse është obligim ta mbrojnë veten e tyre. Atëherë, çfarë mendoni kur në Irak pasuria e muslimanëve shkatërrohet dhe toka pushtohet? Muslimanët po vriten, shpirtrat e tyre po gjëmojnë dhe e gjithë kjo, a nuk është sulm nga armiku? Nëse themi se dikush dëshiron t'i mbrojë ujugurët nga ai armik i poshtër, a do jetë lufta në këtë rast fitne? Nëse e sheh nje burrë gruan e vet apo fëmijet e tij që po i

www.Forum-islamik.com

merren në burgun Ebu Garib, e pastaj ia dhunojnë ushtarët amerikan, a konsiderohet lufta kundër tyre në këtë rast fitne?

➤ **Kundërpërgjigje ndaj fetvasë së shejh Ubejkanit gjerësisht**

Shejh Ubejkani thotë se rezistenca në Irak, po lufton kundër qeverisë legjitime e cila është në mbrojtje të muslimanëve, e kjo qeveri është qeveria aktuale e Irakut. Prandaj, obligohet për muslimanët ta respektojnë këtë qeveri dhe ndalohet dalja në luftë kundër tyre.

Kjo fetva është e pavlefshme nga Kur'ani, sun-neti dhe Ixhma'ja e umetit. Kjo për shumë arsye. Ndër to përmendim:

1. Kjo është një fetva e zhveshur plotësisht nga petku i sheriatit, por e bazuar në mendime të sjella nga

www.Forum-islamik.com

llogjika e tij. Kësaj fetvaje shejh Ubejkani i ka veshur petkun e sheriatit në mënyrë që ta justifikojë përpara muslimanëve.

2. Këtë fetva e mbështet në fjalët e Ehlu sun-netit. Prandaj, e konsideron si një fetva që e kanë përkrahur edhe dijetarët e Saudisë dhe Irakut. Gjithashtu, kjo fetva e dhënë nga shejh Ubejkani ka gjetur përkrahje edhe nga shteti shi'it i Irakut. Por ka harruar shejh Ubejkani të na thotë argumentet fetare që tregojnë se Qeveria e Irakut është legjitime. Nuk mjafton vetëm të themi se qeveria është legjitime, por duhet të jemi besnik me muslimanët për ta vërtetuar legjitimitetin e qeverisë nga ana sheriatike. Ajo që dihet nga e gjithë bota është se Amerika shkoi në Irak për të rrëzuar pushtetin e Sadamit dhe për të përhapur demokracinë në atë vend. Më pas vendosi qeverinë e Alauit dhe të Malikiut, duke formuar një qeveri demokratike me zgjedhje të lira parlamentare. Nëse qeverinë aktuale demokratike të Irakut do e konsiderojmë si Qeveri Islame, atëherë do të ishte më mirë për popullin e Irakut, që të qëndronin poshtë flamurit të Sadamit, sesa poshtë flamurit të amerikanëve dhe rafidive?

3. Argumentohet me fjalën e ibën Muflih që thotë se disa mbretëri muslimane në Endelus (Spanjë) kanë kërkuar ndihmën e disa krishterëve, kundër disa

www.Forum-islamik.com

mbretërve muslimanë që ishin zullumqar. Dijetarët e asaj kohe e lejuan diçka të tillë. Pastaj, tregon se e njëjta gjë ndodhi edhe në luftën e Kuvajtit. Komisioni i përhershëm i dijetarëve, dhanë fetva që të përkrahet Saudia nga ana e amerikanëve për luftimin e Sadamit. Kjo, sepse amerikanët ishin poshtë flamurit të Saudisë dhe po luftonin një prijës tagut. Në fund argumentohet se kjo lloj ndihme që kërkohet nga jobesimtarët është e lejuar. Më pas bën një kijas (krahasim) me ndihmën që po i jep Amerika Qeverisë Irakiene për të luftuar terrorizmin.

Këtij dyshimi do i kundërpërgjigjemi në tri aspekte kryesore:

- Është e vërtetë se të krishterët kanë ndihmuar disa mbretëri Islame, por lufta e tyre ka qenë poshtë flamurit të mbretërve musliman. Nuk kanë luftuar muslimanët poshtë flamurit kristian kundër muslimanëve, ashtu siç po bëjnë sot mbretërit arab në luftë kundër terrorizmit poshtë flamurit të Romës (Amerikës dhe Evropës).
- Kërkimi i ndihmës nga jobesimtarët nuk është i lejuar me shumicën e dijetarëve Islam, sipas fjalës së Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem:

www.Forum-islamik.com

“Unë nuk kërkoj ndihmë nga mushrikët”.⁹⁴

Shikoni fetvanë e shejh Albanit që flet për ndalimin e trupave amerikanë në Saudi.

- Në Irak, qeveria prezente po lufton poshtë flamurit të Amerikës dhe është themeluar sipas ligjeve demokratike amerikane dhe jo sipas ligjeve sheriatike të Islamit. Amerikanët bashkë me shijat po luftojnë muslimanët në përgjithësi, kurse Ehlu su-netin në veçanti. Këtë gjë e kupton edhe injoranti, e si mundet të mos e kuptojë dijetari. Nga të kundërtat e Islamit është ndihma e jobesimtarëve kundër muslimanëve. Këtë e kanë përmendur të gjithë dijetarët e Saudisë. Prandaj themi se çdo lloj ndihme që u jepet amerikanëve në luftë kundër muslimanëve, është kufër i madh që të nxjerr nga Islami. Atëherë, pse Qeveria Irakiene e cila bashkëpunon me amerikanët në luftë kundër muslimanëve, është qeveri legjitime dhe lufta kundër tyre është fitne?

4. Fetvatë e Feuzanit dhe Ubejkanit që e ndalojnë xhihadin me pretendimin se është fitne dhe se Qeveria e Irakut është legjitime, janë të pavlefshme. Ne do i kundërpërgjigjemi atyre siç vijon:

⁹⁴ Transmeton Muslimi.

www.Forum-islamik.com

- Qeveria e Irakut është themeluar që të luftojë Islamin dhe kjo është e qartë tek dijetarët e Haramejnit. Prandaj, çfarëdo lloj ndihme që i bëhet kësaj qeverie është kufër i madh që të nxjerr nga Islami.
- Në krye të kësaj qeverie, bëjnë pjesë shekullaristët dhe rafiditë. Të dyja palët, luftojnë kundër Islamit dhe konsiderohen si jobesimtarë me ixhmanë e dijetarëve.
- Qeveria e Irakut është spiune dhe përkrahëse e pushtuesit amerikan, për këtë arsye ajo konsiderohet e pavlefshme nga ana fetare.

5. Kjo qeveri, është themeluar në kundërshtim me rregullat e shariatit. Kjo për disa arsye, e ndër to përmendim:

- Njerëzit e eksperiencës dhe marrëveshjes, nuk e kanë pranuar këtë qeveri. Bile as muslimanët e thjeshtë nuk e kanë pranuar, por është vendosur me dhunë nga ana e pushtuesit amerikan në favor të interesave të tij.
- Kjo qeveri po vret muslimanët, po vjedh pasurinë e tyre dhe po ç'nderon femrat muslimane çdo ditë. Këtë gjë e realizon me ndihmën e amerikanëve.

www.Forum-islamik.com

- Qeveria prezente po zbaton ligjet shekullariste, demokratike dhe nuk po zbaton ligjin e Allahut të Madhëruar. Shi'itët dëshirojnë të formojnë në Irak Perandorinë Perse, ashtu siç duan amerikanët një qeveri me vlera demokratike. Si pushteti i shijave, ashtu edhe ai i amerikanëve kundërshtojnë dhe luftojnë ligjin e Allahut të Madhëruar. Kurse shteti Islam i Irakut dëshiron zbatimin e shariatit, urdhërimin për të mirë dhe ndalimin nga e keqja. Për këtë qëllim ky shtet po luftohet si nga shijat e Iranit dhe Irakut, ashtu edhe nga amerikanët, përkrahësit e çifutëve.

6. Ubejkani nuk e konsideron prezencën e Amerikës në tokën e Irakut si okupatore, por ai e konsideron prezencën e Amerikës në Irak, si legjitime nga ana shariatike. Ai thotë se ka marrëveshje mes Qeverisë Irakiene dhe asaj amerikane. Për këtë arsye nuk e konsideron si okupatore, as qeverinë prezente të Irakut.

7. Nëse ndodh ndonjë luftë midis Amerikës dhe Saudisë, shi'itët dhe qeveria prezente e Irakut nuk ka dyshim se do të jenë me amerikanët. Atëherë, si do të jenë fjalët e shejh Ubejkanit ndaj kësaj qeverie?

www.Forum-islamik.com

8. Qeveria prezente për të cilën ka dhënë fetva shejh Ubejkani, se duhet respektuar dhe ndalohet lufta kundër saj, kjo fetva i urdhëron muslimanët për përforcimin e bazave amerikane. Amerika në Irak po bën padrejtësi, shtypje kundër muslimanëve dhe kufri i Qeverisë Irakiene duket qartë në përforcimin dhe mbrojtjen e Amerikës. Atëherë, me gjithë kufirin e qartë të kësaj qeverie si e konsideroni haram luftimin e saj?

9. Iraku është pushtuar më parë nga mongolët rreth viteve 630-660 hixhrij, ashtu siç u pushtua nga amerikanët në vitin 2003. Të dy pushtuesit përpara se ta luftonin Irakun, i bënë embargo. Të dy pushtuesit u ndihmuan nga shijat në luftimin e Irakut. Të dy pushtuesit përhapën kufirin, padrejtësinë dhe e shkatërruan tokën e Irakut. Ka një ndryshim të vetëm midis amerikanëve dhe mongolëve. Mongolët pas një farë kohe pranuan Islamin dhe aplikuan sheriatin, ndërsa amerikanët po aplikojnë fenë demokratike.

Atëherë, shtrohet pyetja:

Nëse Profeti sal-lallahu alejhi ue sel-lem do të pranonte Qeverinë e Ebu Xhehlit. Ebu Bekri Qeverinë e Musejlemetul-Kedhabit. Ibën Tejmije Qeverinë e Tetarëve dhe muslimanët në këtë kohë Qeverinë Amerikane bashkë me miqtë e saj, atëherë pse nuk

www.Forum-islamik.com

duhet të pranohet edhe Qeveria e Dexhalit kur të dalë me preteksin se ajo është një qeveri legjitime dhe ka përkrahjen e shumicës?

Gjithë këto që përmendëm, nuk e mohojnë respektin e dijetarëve, por feja e Allahut tek ne është më e dashur se çdokush tjetër dhe e vërteta meriton të ndiqet më shumë se mendimet e dijetarëve.

SHKOLLA PROFETIKE

“BILADU-RAFIDEJN”



KAPITULLI I GJASHTË

KËRKUESIT E HILAFETIT TË DREJTË DHE Ç'LIRUESIT E PALESTINËS

Transmetohet nga ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) se Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Ishim ne sahabët pranë të Dërguarit të Allahut dhe në atë moment erdhën disa djem nga fisi beni Hashim. Kur i pa Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ata, në atë moment i ndryshoi ngjyra e fytyrës së tij. I thash:-O i Dërguari i Allahut! Pamë tek fytyra jote diçka që ti nuk e pëlqeje. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem tha:-Ne jemi Ehlul-Bejti (familja e Profetit), që Allahu na ka**

www.Forum-islamik.com

zgjedhur botën tjetër mbi jetën e kësaj bote. Ehlul-Bejti, në kohën e fundit do të përjetojë sprova, shkatërrime dhe burgosje. Derisa të vijë një popull nga ana e lindjes, që kanë flamuj të zinj. E kërkojnë hajrin, por nuk u jepet atyre diçka e tillë. Luftojnë për hakun, derisa fitojnë. Ata nuk do ta pranojnë këtë hajr, derisa ta çojnë tek një burrë nga familja ime. Ai do e mbush tokën me drejtësi, sepse ata e kishin mbushur plot me padrejtësi. Kur t'i shikoni këta flamuj, shkoni tek ata edhe zvarrë mbi dëborë". Transmeton ibën Maxhe.

Transmetohet nga Ebu Hurejre (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) se Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "Do të dalin nga Horosani flamujt e zinj dhe nuk do të ndalen së luftuari, derisa të arrijnë në Ilja (Aksa)". Transmeton imam Ahmedi.

TEMË

KUSH JEMI NE

➤ E përgjithshme për palën e ndihmuar

1. Transmetohet nga Mua'uijeh (Allahu qoftë i kënaqur prej tij), që i Dërguari i Allahut ka thënë: "Vazhdojnë një popull nga umeti im ekzekutues të urdhërit të Allahut. Nuk u prish punë ai që i braktis dhe as ai që i kundërshton, derisa vjen urdhëri i Allahut e ata janë të tillë." Umejri tha: Malik ibën Juhamir tregon se Muadhi thotë se ata do

www.Forum-islamik.com

të jenë në Sham. Atëherë, Mua'uijeh tha: Maliku pretendon se e dëgjoi Muadhin të thotë: Do të jenë në Sham.⁹⁵

2. Nga ai sërish transmeton se Profeti sal-lallahu alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Vazhdojnë një popull nga umeti im ekzekutues të urdhërit të Allahut. Nuk u prish punë ai që i mohon dhe as ai që i braktis, derisa vjen urdhëri i Allahut e ata janë të tillë.”** Atëherë Malik ibën Juhamir tregon se Muadhi ka treguar se ata do të jenë në Sham. Atëherë, Mua'uijeh tha: Maliku pretendon se e dëgjoi Muadhin të thotë: Do të jenë në Sham.⁹⁶

3. Transmetohet nga Xhabir ibën Semureh (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) se i Dërguari i Allahut ka thënë: **“Vazhdon kjo fe ekzistuese. Do të luftojnë për të një grup nga muslimanët, derisa vjen sa'ati (ora e kiametit).”**⁹⁷

4. Nga Abdullah ibën Shemasete el-Mehrij (Allahu qoftë i kënaqur prej tij), që ka thënë: Isha tek Musel-lemeh ibnu Muhal-led dhe te ai ishte Abdullah ibnu Amru bin Asi që tha: **“Nuk vjen koha e kiametit përveçse mbi njerëzit më të këqinj. Ata do të jenë**

⁹⁵ Transmeton El-Buhari, 3641.

⁹⁶ Transmeton El-Buhari, 7460.

⁹⁷ Transmeton Muslimi, 66\13.

www.Forum-islamik.com

më të këqinj se njerëzit e xhahilijes (inJORANCËS para Islamit). Nuk do ta lusin Allahun për diçka, veçse do t'ua kthejë atë mbrapsh." Ndërkohë vjen Ukbeh ibn Amir Musel-lemetu dhe i thotë: O Ukbeh, dëgjo se ç'thotë Abdullahi. Atëherë Ukbeh tha: Ai është më i ditur, ndërsa unë e dëgjova të Dërguarin e Allahut të thotë: **"Vazhdojnë një grup nga umeti im, që luftojnë për urdhërin e Allahut, ngadhënjimtarë mbi armikun. Nuk u prish punë ai që i kundërshton, derisa u vjen kiameti e ata janë të tillë."** Atëherë, Abdullahi tha: Po. Pastaj Allahu dërgon një erë si erë misku, ku prekja e saj do të jetë si prekja e mëndafshit. Nuk lë person, në zemrën e të cilit ka besim sa një kokërr elbi veçse e vdes, më pas mbeten njerëzit më të këqinj, e mbi ata do të bëhet kiameti.⁹⁸

5. Transmetohet nga Mua'ujeh ibën Kurreh, e ky nga babai i tij (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre), se ka dëgjuar Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem të thotë: "Vazhdojnë një grup nga umeti im të ndihmuar. Nuk u prish punë ai që i braktis, derisa vjen sa'ati."⁹⁹

⁹⁸ Transmeton Muslimi, 68\13.

⁹⁹ Transmeton Muslimi, 68\13.

www.Forum-islamik.com

6. Nga Ebu Hurejre (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) se ka dëgjuar Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem të thotë: **“Vazhdojnë një grup nga umeti im, kujdestarë të urdhërit të Allahut. Nuk u prish punë ai që i kundërshton.”**¹⁰⁰

➤ **Lidhur me cilësinë e triumfit në të vërtetë**

1. Transmetohet nga El-Mugireh (Allahu qoftë i kënaqur prej tij), se ka dëgjuar Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem të thotë: **“Vazhdojnë njerëz nga umeti im triumfatorë, derisa u vjen urdhëri i Allahut, e ata janë triumfatorë.”**¹⁰¹

2. Nga ai sërish, se ka dëgjuar Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem të thotë: **“Vazhdojnë një grup nga**

¹⁰⁰ Transmeton Ibën Maxheh, 7.

¹⁰¹ Transmeton El-Buhari, 3640.

umeti im triumfatorë, derisa u vjen urdhëri i Allahut, e ata janë triumfatorë.”¹⁰²

3. Nga ai sërish, se ka dëgjuar Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem të thotë: “Vazhdojnë një komb nga umeti im triumfatorë mbi njerëzit, derisa u vjen urdhëri i Allahut.”¹⁰³

4. Nga Mua’uijeh (Allahu qoftë i kënaqur prej tij), se ka dëgjuar Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem të thotë: “Atij që Allahu ia dëshiron të mirën i jep kuptim në fe dhe Allahu jep, ndërsa unë ndaj. Do të vazhdojnë nga ky umet një grup triumfatorë mbi kundërshtarin, derisa vjen urdhëri i Allahut, e ata janë triumfatorë.”¹⁰⁴

5. Transmetohet nga Theubani (Allahu qoftë i kënaqur prej tij), se ka dëgjuar Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem të thotë: “Vazhdojnë një grup nga umeti im triumfatorë në të vërtetën. Nuk u prish punë ai që i braktis, derisa vjen urdhëri i Allahut e ata janë të tillë.”¹⁰⁵

¹⁰² Transmeton El-Buhari, 7311.

¹⁰³ Transmeton El-Buhari, 7459.

¹⁰⁴ Transmeton El-Buhari, 3116.

¹⁰⁵ Transmeton Muslimi, 60\13.

www.Forum-islamik.com

6. Transmetohet nga el-Mugireh (Allahu qoftë i kënaqur prej tij), se ka dëgjuar Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem të thotë: **“Vazhdojnë një palë nga umeti im triumfatorë mbi njerëzit, derisa u vjen urdhëri i Allahut e ata janë triumfatorë .”** ¹⁰⁶

